

ABDULAZIZ MUSTAFA

PARA SE TË SHKATËRROHET EL-AKSA



Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

PËRPARA SE TË SHKATËRROHET XHAMIA EL-AKSA

Abdulaziz Mustafa

Botuar nga: SHB SIRA

© Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit Genc Mustafa Çurgu.

PARATHËNIE

Lavdërimi i takon vetëm Allahut, Zotit të Botrave. Paqja dhe bekimi i Tij qoftë mbi Vulën e të gjithë të dërguarve, Muhamedin (s.a.v.s.), familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Që nga mbajtja e konferencës së parë çifute në qytetin Bal të Zvicrës me 1897 dhe suksesi i çifutëve, të cilët në bashkëpunim me të krishterët, ia dolën mbanë të realizonin dy komplotet më të rrezikshme kundër Ummetit islam:

Rrëzimin e Kalifatit Islam më 1924, dhe Ngritjen e shtetit çifut të Izraelit më 1948. Që nga ajo kohë, lufta ndërmjet jehudizmit dhe Islamit ashpërsohet dhe ndizet edhe më shumë me kalimin e ditëve.

Ai që studion dhe mediton me kujdes mbi rrjedhën e këtij konflikti përballet me të vërteta të mëdha dhe fakte të rëndësishme që dikush mundohet t'i zvogëlojë. Nga këto të vërteta vihet re se i ashtuquajturi "Izrael", i cili e ka bërë fenë strumbullar rreth së cilit vërtitet politika, gjatë të gjitha fazave të konfliktit ka kaluar nga fitorja në fitore, duke u forcuar dhe zgjeruar gjithnjë e më shumë, ndërkohë që regjimet laike të gjendura përballë tij në këtë betejë kanë kaluar nga dështimi në dështim dhe nga humbja në humbje.

Që në fillimin e betejës, çifutët ngritën vetëm një flamur, flamurin e Tevratit dhe u radhitën pas një qëllimi të vetëm - Tokës së Premtuar. Shtetin e tyre e emërtuan me emrin e një profeti, atë të Jakubit (a.s.) ose Izraelit, ndërsa Tevratin e bënë kushtetutën e shtetit të tyre. Ata nuk pranuan që të përcaktonin kufijtë e këtij shteti, veçse pasi të kishin përfshirë në to kufijtë që përcakton Teurati, kurse të gjitha betejat i zhvilluan pas rabinëve dhe dijetarëve të tyre. Pavarësisht nga të gjitha drejtimet politike, ushtarake, ekonomike dhe shoqërore të shtetit të tyre, ata vendosën një simbol të vetëm, i cili qëndron në mes të flamurit izraelit, yllin e Davidit, që simbolizon kiblen fetare të kësaj shoqërie të cilën duan ta rikthejnë pas dymijë vjet mungese. Kjo kible është Tem- pulli i Tretë i Sulejmanit, të cilin ata sot duan ta ndërtojnë në vendin e Xhamisë El-Aksa për të qenë simbol i Shtetit Fetar Çifut Botëror me emër, kushtetutë, kufij dhe emblemë fetare, në mënyrë që të plotësohet tabloja e Shtetit Botëror Çifut të ngritur mbi gërmadhat e Kalifatit Islam.

Që nga krijimi i shtetit çifut kanë kaluar pesëdhjetë vjet dhe të gjitha faktet tregojnë për dështimin, mundjen dhe tërheqjen e turpshme të drejtimit laik me të gjitha format e tij, socializmin, nacionalizmin, progresivizmin etj.

Ai që u mund dhe u tërhoq përpara jehudizmit nuk është aspak Islami, por laicizmi, i cili hodhi armët dhe u dorëzua. Jo! Islami nuk është mundur nga jehudizmi në këtë betejë për të vetmen arsye, sepse deri më sot atij nuk iu është dhënë mundësia që të përballlet në këtë betejë fetare, e cila fetarisht vërtitet vetëm nga një anë.

Ka ardhur koha për bijtë e kësaj feje që të ngrihen në emër të saj për të kryer misionin e tyre: ndërprerjen e tërheqjes së laicizmit dhe dhënien fund të marshimit çifut. Dhe lavdërimi i përket vetëm Allahut të Lartësuar që tani shohim rreze drite të dalin nga zemra e Tokës së Bekuar dhe rrethinat e Xhamisë El-Aksa, të përfaqësuar nga Lëvizja e Rezistencës Islame, ku edhe gurët në duart e fëmijëve, të së cilës, gati flasin që t'i dëgjojë e gjithë bota: "Ja, Islami po kthehet për të marrë drejtimin e luftës dhe për ta shpëtuar Ummetin Islam nga poshtërimi, dorëzimi dhe humbja".

Abdulaziz Mustafa 20/7/1410 hixhri

ARMIQËSIA E ÇIFUTËVE KUNDËR ISLAMIT DHE PASUESVE TË TIJ NË KOHËRAT E VJETRA DHE SOT ARMIKU YNË I VJETËR

Nuk është aspak i rastësishëm paralajmërimi që bën Allahu (xh.sh) në Kur'anin e Shenjtë për armiqësinë e çifutëve dhe pozicionimin e tyre në radhët e para të armiqve të besimtarëve:

“Ti me siguri do të shohësh se armiqtë më të flaktë të besimtarëve janë hebrenjtë dhe politeistët;...”¹

Ashtu siç nuk është e rastësishme as edhe përmendja e shpeshtë që i bën Kur'ani këtij lloji njerëzish dhe në këtë mënyrë. Rrëfimi për Beni Israilët dhe çifutët zë një pjesë të madhe të Zbritjes Hyjnore, si në suret e zbritura në Mekë, ashtu edhe në ato të zbritura në Medinë, në të cilat përmendja e tyre bëhet herë në mënyrë deklarative dhe herë në mënyrë cekëse, herë hollësisht dhe herë shkurtimisht. Dhe kjo ndodh në pesëdhjetë sure nga gjithsej 114 suret e Kur'anit të Madhërishtëm.

Po! Asnjëherë nuk ka qenë një rastësi, përkundrazi ka një të fshehtë, bile disa të fshehta. Pas gjithë kësaj rëndësie që i kushton Kur'ani i Shenjtë çifutëve, në formë paralajmërimi dhe sqarimi të pozicionit të tyre, ekzistojnë shumë urtësi hyjnore.

Ngjarjet e njëpasnjëshme që ndodhën në kohën e zbritjes së Shpalljes Hyjnore na zbulojnë shumë të fshehta, ndaj ia vlen të ndalemi gjatë përpara tyre. Pas përfundimit të periudhës mekase, filloi periudha medinase dhe me kalimin e ditëve, dalëngadalë filluan të zbuloheshin anët e të vërtetës, të vërtetës së armiqësisë çifute kundër Islamit dhe ndjekësve të tij.

Kur u bë e qartë se i Dërguari i fundit nuk ishte nga bijtë e Izraelit, në zemrat e çifutëve u ndez flaka e cmirës dhe urrejtjes kundër tij, ndaj filluan një varg të tërë komplotesh kundër Islamit dhe të Dërguarit të tij. Për pasojë, u bë e domosdoshme që të ndërmerrej si kundërpërgjigje një varg goditjesh xhahadi

¹ Kur'ani: Maide, 82.

për ndërprerjen e këtyre kompleteve. I Dërguari (s.a.v.s.) e udhëhoqi personalisht këtë xhihad kundër çifutëve, i cili vazhdoi gjatë. Pjesa e parë e këtij xhihadi filloi në çerekun e parë të periudhës medinase dhe vazhdoi deri në dëbimin e tyre nga Medina, ndërsa në çerekun e dytë dhe atë të tretë, përfundoi dëbimi i tyre nga fshatrat e tjera përreth Medinës.

Në vazhdimësi, ndodhi vrasja e Ebu Ifkut, i cili me poezitë e tij nxiste të tjerët kundër të Dërguarit të Allahut; dëbimi i fisit Benu Kajnuka', të cilët u tallën me ato që për Islamin janë të shenjta, kur cenuan një grua muslimane dhe zbuluan avretin e saj; vrasja e Kaab bin Eshref-it, i cili me poezitë e tij nxiste të tjerët kundër të Dërguarit dhe përgojonte gratë e muslimanëve; dëbimi i fisit Benu Nadir që komplotuan për të vrarë Muhamedin (s.a.v.s.), duke i hedhur mbi kokë një gur të madh në kohën kur ai ishte ulur në rrëzë të një shtëpie dhe me pas, elimini i fisit Benu Kurejdha, pasi që ndihmuan haptas fiset idhujtare që sulmuan Medinën, megjithëse kishin nënshkruar një pakt bashkëpunimi për mbrojtjen e saj krahas muslimanëve.

Më pas, i Dërguari (s.a.v.s.) e hodhi shikimin te çifutët e tjerë që banonin jashtë Medinës dhe që kishin gisht në përbetimet kundër muslimanëve. Muslimanët vranë Ebu Rafi' Selam bin Ebul- Hakik En-Nadari-un që banonte në Hajber, sepse kishte tubuar të gjitha fiset pagane arabe në luftë kundër muslimanëve; më pas, Usejr bin Razim-in dhe një grup shokësh të tij, pasi u zgjodh nga çifutët e Hajberit si kryetar i tyre pas vrasjes së Ebu Rafi'-it dhe në fund, çliruan Hajberin dhe fshatrat e tjera çifute, dy muaj pas marrëveshjes së Hudejbijes.

Por a u ndërpre përbetimi çifut në këtë pikë? E vërteta është se nepërka çifute i rezistoi vdekjes dhe nuk hoqi dorë nga kafshimet e saj, me shpresë se do ta godiste Islamin për vdekje. Kësaj here objektivi i saj ishte jeta e të Dërguarit (s.a.v.s.). Dhe çifutët ia arritën asaj që donin kur komplotuan për helmimin e Muhamedit (s.a.v.s.), duke shtuar edhe një krim të ri në listën e gjatë të vrasjeve të profetëve. Dhe ja si ndodhi:

Gruaja e njërit nga kryetarët e çifutëve i dhuroi Muhamedit (s.a.v.s.) një dele të pjekur, në të cilën kishte hedhur helm, duke e ditur se ai e pranonte dhuratën. Pasi futi në gojë një copë të vogël prej

saj, i Dërguari (s.a.v.s.) nuk e pëlqeu atë dhe tha: "Kjo dele po më thotë se është e helmuar". Si pasojë e ngrënies nga kjo dele, vdiq një nga shokët e Profetit (s.a.v.s.), Bishr ibn El-Berra', ndërsa ai vetë u prek nga ajo që hëngri, aq sa kur u sëmur për herë të fundit para se të vdiste, i tha motrës së Bishrit: "Tani po ndjej se si po më këputet damari i zemrës nga ajo që hëngra me vëllanë tënd". Shokët e tij e konsideronin atë të rënë shehid për shkak të ngrënies nga ajo dele.

Në tefsirin e Ibn Kethirit në lidhje me ajetin Kur'anor:

"...E sa herë që u erdhi ndonjë i dërguar me ç'ka nuk u pëlqeu juve, a nuk u bëtë kryelartë dhe disa prej tyre i përgënjeshtruat e disa i vrisni?"²

thuhet: "Allahu i Lartësuar nuk thotë: Dhe disa i vratë, sepse me këtë gjë Ai do që t'i përshkruajë ata edhe në të ardhmen, për shkak se ata u munduan ta vrasin Profetin (s.a.v.s.) me helm dhe magji". Me magjinë, ai i referohet ngjarjes me çifutin Lebid Ibnul-A'sam që i bëri magji të Dërguarit (s.a.v.s.).

I tillë ishte pozicioni i armiqve të Allahut ndaj besimtarëve në kohën më të lavdishme që ka parë kjo botë. Përse të mos komplotonin çifutët kur kishin qenë vrasësit e profetëve të mëparshëm; përse të mos ndiznin flakën e luftës kur gjithmonë kishin qenë luftënxitës dhe gjakpirës të popujve?

"Sa herë që ndezën zjarr për luftë, Allahu e shoi atë, e ata përpiqen për shkatërrime mbi tokë. Allahu nuk i do ngatërrestarët."³

Kjo prishje dhe ky korrupsion ka lënë njollat e tij të zeza në faqet e historisë si një nënshkrim për çifutët dhe dëshmitar i faktit që ata janë të pranishëm kudo ku mund të përhapet korrupsioni. Ja disa fakte dhe protagonistë kryesorë të tij:

- Çifutët Ebu Ifk, Kaab ibn Eshref dhe Ibn Ebul-Hakik ishin të parët që nxitën urrejtjen, i nxorën vështirësi të mëdha shtetit të ri islam në Medinë dhe tubuan të gjithë çifutët, kurejshët e Mekës dhe fiset e tjera pagane arabe në luftë kundër muslimanëve.

² Kur'ani: Bekare, 87.

³ Kur'ani: Maide, 64.

- Çifuti Abdullah ibn Sebe' ishte ai që nxiti injorantët, tuboi banditët dhe përhapri thashetheme për ngjarjen e dhimbshme të vrasjes së Uthman ibn Affan-it (r.a.) dhe të tjerat që pasuan.
- Çifuti Mit-hat Pasha ishte protagonisti kryesor i nxitjes së lëvizjeve nacionaliste dhe zbatimit të planeve masonë në shtetin e Kalifatit Osman, gjë që çoi së fundi në rrëzimin e Kalifatit nga dora e çifutit Mustafa Qemal Ataturk.
- Çifuti Karl Marks ishte autori i valës shkatërruese të ateizmit, e cila me vonë u shndërrua në fuqi dhe shtet, bile kamp botëror shtetesh që u ngritën mbi gërmadhat e vendeve islame.
- Çifuti Zigmund Frojd ishte autori i teorisë së instinkteve kafshërore që më pas u shndërrua në disiplinë shkencore, e cila vazhdon të shkatërrojë mendjen e të rinjve që iu reklamohet si shkencë dhe progres.
- Çifuti Dorkajm qëndron pas përhapjes së mendimeve shkatërrimtare për familjen dhe zgjidhjes së lidhjeve të shenjta në shoqëri.
- Çifuti Zhan Pol Sartr ishte protagonisti kryesor i rrymës së edukatës së shthurur në marrëdhëniet personale dhe kolektive.
- Çifuti Samuel Zuejmer ishte ai që planifikoi lëvizjet e kristianizimit ose ta themi më qartë, të përhapjes së mosbesimit, në vendet muslimane. Synimi i tij nuk ishte t'i fuste Muslimanët në fenë e krishterë, por t'i nxirrte Muslimanët nga Islami, duke përplasur Islamin me krishterimin.
- Çifuti Teodor Hercl ishte ai që mbolli farën e fatkeqësisë së kohës sonë, e cila njihet si kriza e Lindjes së Mesme, kur planifikoi dhe projektoi tiparet e shtetit çifut në librin e tij me të njëjtin emër, të atij shteti që lindi pas vdekjes së tij dhe u bë qendra e përhapjes së korrupsionit në tokë.

ARMIKU YNË I RI

Më 1948, në kohën kur bandat çifute filluan sulmin për uzurpimin e Tokës së Shenjtë dhe kur Lëvizja Islame u vu në ballë të luftës kundër këtij rreziku, ambasadorët e Britanisë së Madhe, Francës dhe SHBA-së në Egjipt ndërhyjnë me shpejtësi te mbreti i atëhershëm i Egjiptit, Faruku, duke kërkuar prej tij që t'i jepte një goditje të fortë kësaj lëvizjeje islame, e cila në atë kohë përfaqësohej nga xhemati i Vëllezërve Muslimanë. Dhe me të vërtetë, menjëherë doli urdhri për rrethimin e kampeve të muxhahidinëve në frontin e luftës dhe çarmatosjen e tyre, pastaj dërgimin e tyre nëpër burgje dhe kampe përqendrimi, në të cilat ata morën vesh shumë ngjarje që kishin ndodhur në Egjipt para kthimit të tyre. Në fillim ata morën vesh për urdhrin për shpërndarjen e detyruar të xhematit të Vëllezërve Muslimanë dhe më pas, arrestimin e shumë prej krerëve dhe anëtarëve të tij. Ky urdhër kishte dalë në mbrëmjen e 8 dhjetorit të vitit 1948.

Pas kësaj ndodhi vrasja me atentat e imam Hasen El-Bena-s (rahmetullahi alejhi) në mbrëmjen e 12 shkurtit, pikërisht në ditëlindjen e mbretit Faruk. Pas pak ditësh u bë e qartë se kush qëndronte pas këtyre ngjarjeve. Po gatuhej marrëveshja e Rodit me çifutët dhe këta të fundit së bashku me agjentët e tyre po punonin për përgatitjen e terrenit për nënshkrimin e saj nga mbreti Faruk më 14 shkurt 1949.

Ndërhyrja e ambasadorëve të mbretit Faruk ishte e nxitur dhe e drejtuar nga dora e çifutëve. Bile vendimi për shpërndarjen e Vëllezërve Muslimanë ishte marrë nga këta ambasadorë në qytetin Fajid.

Gjatë viteve që pasuan këto ngjarje, çifutët dhe agjentët e tyre punuan për asgjësimin e çdo filizi të lëvizjes islame përpara se të forcohej. Për këtë qëllim u mbajtën simpoziume dhe u përgatitën studime. Në muajin prill të vitit 1977, instituti amerikan Truman dhe Fakulteti i Studimeve Islame!!! ... në Universitetin Çifut organizuan një simpozium që kishte si qëllim studimin e veprimtarisë islame në Azi, në të cilin morën pjesë 30 ekspertë nga SHBA-ja, Kanadaja, Franca, Holanda, Japonia, Filipinet, Australia dhe ... Izraeli. Drejtues i këtij simpoziumi ishte profesori çifut Joravi Jisrael. Merreni me mend vetë se çfarë mund të hulumtonin dhe studionin nën drejtimin e tij.

Ai që ndjek me kujdes atë që i ndodh sot Lëvizjes Islame, mund të nxjerrë përfundimin se ekziston një lidhje e dyshimtë ndërmjet goditjeve të drejtuara kundër kësaj lëvizjeje dhe shumë gjërave që përgatiten në errësirë, të cilat janë gjithmonë në interesin e çifutëve dhe planeve të tyre në rajon.

Dhe ja disa fakte që tregojnë këtë lidhje, të cilat po i marrim vetëm nga një vend, Egjipti:

Siç ishte arrestimi i pararojës së muxhahidinëve të Vëllezërve Muslimanë, vrasja e imamatit të tyre dhe shpërndarja e xhematit një uжди e fshehtë që i parapriu nënshkrimit të marrëveshjes së Rodit midis çifutëve dhe qeverisë së Nukrashi Pashës në kohën e Farukut, i tillë ishte edhe ekzekutimi i një sërë prijësish të kësaj lëvizjeje, veçanërisht i atyre që kishin marrë pjesë në xhihad kundër çifutëve.

Në vitin 1956, mijëra anëtarë dhe simpatizantë të lëvizjes islame u hodhën nëpër burgje. Në po të njëjtin vit, Izraeli përparoi në vijën e frontit dhe arriti të pushtojë deri edhe kanalën e Suezit.

Më 29 gusht 1966, ekzekutohet Sejjid Kutubi dhe një numër shokësh të tij, ndërkohë që shokët e tjerë dënohen me afate të ndryshme burgimi. Pas disa muajsh, Izraeli përparon në një fushë beteje të zbrazët, i shkakton disfatë tre shteteve arabe më 5 qershor dhe pushton Kudsën, Sinain dhe lartësitë Golan.

Në vitet shtatëdhjetë, përpara nënshkrimit të marrëveshjes së paqes midis Sadatit dhe çifutëve, Lëvizjes Islame iu dhanë një varg goditjesh të përqendruara në periudha të ndërprera gjatë viteve 1974, 1975, 1976 dhe 1977, kryesisht në formë nxjerrjesh në gjyq, të cilat mjetet e informacionit i pasqyronin me ngjyrimë frikësuese. Për këtë qëllim, u përdorën gjykatat ushtarake, në mënyrë që të krijonin te populli përshtypjen se përfundimi i drejtimit islam ishte i hidhur, veçanërisht kur ndërhynte në politikën e lartë të shtetit në lidhje me paqen me Izraelin. U dhanë shumë dënime me vdekje, burgime të përjetshme dhe me afate të ndryshme. Ky numër i madh paditjesh, masash dhe dënimesh shkonte paralel me madhësinë e asaj që ndodhi në fundin e atij dhjetëvjeçari, në vitet 1977-1980. Fjala është për serinë e kompleteve të përgatitura nga çifutët dhe ndihmësit e tyre, nga të cilat përmendim marrëveshjen e Kemp Dejvidit dhe paqen separat me Izraelin.

Në fillimin e viteve tetëdhjetë, Sadati mblodhi nëpër burgje dhe kampe internimi krerët dhe anëtarët e të gjitha lëvizjeve islame, pavarësisht nga drejtimit e tyre të ndryshme, për shkak të kundërshtimit të tyre të hapur ndaj normalizimit të marrëdhënieve me çifutët. Ndërkohë Sadati qëllimisht krijoi një problem të ri duke akuzuar islamistët se po nxitnin përçarjen sektare me të krishterët, duke shfrytëzuar ngjarjet e Qoshes së Kuqe, për të cilat dihet botërisht se ishin të krishterët ata që e ndezën këtë zjarr, kur njëri prej tyre hapi zjarr ndaj muslimanëve që po faleshin në xhaminë Nedhir të Kajros, si pasojë e të cilit u vranë dhe u plagosën një numër i madh i tyre.

Vetëm Allahu i Lartësuar e di se çfarë hapi kishte ndërmend të ndërmernte Sadati pas këtij shkallëzimi të dyshimtë të ngjarjeve, por me sa duket, ky veprim erdhi si plotësim i dëshirës së madhe të çifutëve për shpejtimin e hapave për mbylljen pas hekurave të burgjeve të gjithë kundërshtarëve të paqes me ta. Kjo gjë u duk qartë nga deklarata e kryeministrit të atëhershëm izraelit Menahem Begin e transmetuar nga të gjitha agjencitë e lajmeve, të cilën e bëri në përfundim të vizitës së tij në SHBA në fund të muajit gusht të vitit 1981:

"Unë nuk do të jem kurrë i qetë për të ardhmen e marrëveshjes së Kemp Dejvidit dhe amendamenteve të saj, përderisa të mos të ketë përfunduar eliminimi i lëvizjeve fanatike islamike, veçanërisht në Egjipt" dhe vazhdoi më poshtë: "Miku im Sadat ka shfaqur një interesim të madh për dokumentet që i dhashë, të cilat fajësojnë ekstremistët islamikë se po punojnë kundër marrëveshjeve të Kemp Dejvidit dhe po pengojnë procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Izraelin. I sigurova atij nga ana ime se Izraeli nuk do të mjaftohet vetëm me dëgjimin e deklaratave qetësuese, por do që të merren masa të prera dhe të rrepta për t'i dhënë mësim krerëve të këtyre lëvizjeve dhe për t'i vënë kufij atyre. Në rast të kundërt, Izraeli do të vazhdojë ta shohë të ardhmen e paqes me Egjiptin me mosbesim dhe dyshim". Në mbyllje të deklaratës, ai tha: "Miku ynë Sadat ishte po aq i mirë sa ç'e mendonim, sepse akoma pa u nisur mirë nga Egjipti për t'u kthyer në Izrael, filloi një fushatë e rreptë kundër tyre. I uroj atij nga zemra suksese".

Lëvizjet islame që u goditën në Egjipt në fillimin e viteve tetëdhjetë nga miku i hapët i çifutëve u goditën me mënyra edhe më të ashpra nga miqtë e fshehtë të çifutëve edhe në shumë vende të tjera arabe. E gjitha kjo u bë me qëllim që

të zbatohet strategjia e çifutëve në lidhje me marrëdhëniet me Muslimanët. Gazeta çifute "Jediot Ahranot" e datës 11 mars 1987 botoi një artikull në të cilin thuhej:

"Duhet që mjetet tona të informacionit të mos harrojnë një të vërtetë të rëndësishme, e cila është pjesë e strategjisë së Izraelit në luftën e tij kundër arabëve: Ne e arritëm suksesin me përpjekjet tona dhe ato të miqve tanë, e mbajtëm larg Islamit nga beteja jonë me arabët për tridhjetë vjet. Duhet që Islami të mbetet jashtë kësaj beteje përjetë, ndaj nuk duhet të neglizhohet, as edhe për një çast, në zbatimin e planit tonë për moslejimin e zgjimit të shpirtit fetar, në asnjë formë apo mënyrë, edhe sikur të duhet të kërkojmë ndihmë nga miqtë tanë për përdorimin e forcës për shuarjen e çdo nisme për rizgjimin e shpirtit islamik në rajonin që na rrethon".

Çifutët nuk qëndrojnë të vetëm në këtë betejë kundër Lëvizjes Islame, e cila përpiqet që të ngrihet në këmbë. Përveç ndihmës së miqve të çifutëve nga brenda, përkrah tyre qëndron edhe gjiganti amerikan i krishterë, i cili shpall haptas përkrahjen e tyre kundër çdo lëvizjeje islame me influencë. Amerikanët nuk i kursejnë këshillat dhe sugjerimet kur është fjala për zhdukjen e pasuesve të Muhamedit (s.a.v.s.). Gazeta amerikane "Herald Tribune" në numrin e saj të datës 8 tetor 1984 botoi një artikull të shkruar nga Amos Përl Menz me titull "Strategji për parandalimin e një lufte të shenjtë islamike", i cili trajton tre aspekte:

Së pari: Konceptin perëndimor për lëvizjet islame, sipas të cilit:

Ekziston një luftë islame, që zhvillohet në botën islame nga islamistët primitivë dhe fanatikë njëkohësisht kundër Perëndimit, krishterimit, kapitalizmit modern dhe sionizmit.

Kjo luftë nuk bën dallim midis kapitalistit dhe komunistit, amerikanit dhe rusit. Ekzistojnë organizata, që për interesat e tyre, i pajisin dhe u ndihmojnë këtyre lëvizjeve. Së dyti: Taktikën që duhet ndjekur për parandalimin e kësaj lufte të shenjtë:

Lufta kundër islamistëve është një objektivi i ngutshëm që nuk duhet të vonohet.

Lufta kundër tyre duhet të jetë me rreze të shkurtër d.m.th e shpejtë dhe duhet të marrë përparësi.

Është detyrë e domosdoshme që kjo luftë të përfshijë të gjitha lëvizjet në çdo vend të botës islame.

Së treti: Taktika luftarake amerikane e trajtimit të këtyre lëvizjeve:

1. Kur e kërkon nevoja, duhen përdorur të gjitha metodat e atentateve dhe vrasjeve, bile duhen përgatitur njësi të stërvitura posaçërisht për këtë qëllim.
2. Duhen mbështetur të gjitha ato organizata që kërcënohen nga aktiviteti islam dhe lëvizjet islame.
3. Duhen përdorur të gjitha rrjetet e spiunazhit për survejimin e veprimtarisë së lëvizjeve islame.
4. Izolimi politik i klerikëve fanatikë është kusht për bashkëpunimin dhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për këto organizata.

Ndjenjat e Perëndimit të krishterë ndaj shtrirjes së orientimit islam në Lindjen e Mesme i ka përmbledhur shumë qartë ish-presidenti amerikan Riçard Nikson, kur thotë: "Rreziku që kërcënon sot Lindjen e Mesme nuk vjen nga revolucioni komunist, por nga orientimi fanatik fetar atje". Por këtë gjë përpara Niksonit e kanë thënë vëllezërit e tij çifutë, të cilët e kanë humbur durimin për shkak të përtëritjes së lëvizjeve islame që kërcënojnë shtetin çifut. Ja çfarë ka thënë David Ben Gurioni: "Me përjashtim të Islamit, ne nuk i frikësohemi asnjë rreziku tjetër në rajon". Në një fjalim të mbajtur përpara një delegacioni çifutësh amerikanë në muajin janar 1979, ish- ministri çifut i mbrojtjes Moshe Dajan tha:

"Shtetet e Bashkuara dhe vendet evropiane duhet të nxjerrin mësim nga ngjarjet e Iranit, të cilat çuan në shpërthimin e një revolucioni islamik të një forme që nuk pritej aspak. Shtetet perëndimore me në krye SHBA-në duhet që t'i kushtojnë një rëndësi më të madhe Izraelit, sepse ai është vija e parë e mbrojtjes së qytetërimit perëndimor nga erërat e revolucioneve islamike që filluan në Iran, të cilat mund të fryjnë pa pritur dhe pa kujtuar në çdo rajon tjetër të botës islame".

Ndërsa Shimon Peresi, që përfaqëson "pëllumbat" (të ashtuquajturën "vijë të butë") në partitë izraelite, e tha troç këtë gjë, duke shfaqur bindjen e tij për pamundësinë e paqes ose takimit me Islamin në mes të rrugës:

"Paqja në rajon nuk mund të realizohet për sa kohë që shpata e Islamit është e zhveshur. Ne nuk do të jemi kurrë të qetë për të ardhmen tonë derisa Islami të mos ta ketë futur shpatën në mill përjetë".

Ja një i çmendur i krishterë, të cilit urrejtja ndaj muslimanëve ia ka marrë mendjen sa që t'ia kushtojë krejt jetën zhdukjes së udhëheqësve të tyre. Ky është Lindon Larosh, njëri prej kandidatëve të rekomanduar nga Partia Demokrate për të marrë pjesë në zgjedhjet presidenciale të vitit 1979, i cili e përqendroi propagandën e tij elektorale në atë se ai do të punonte për zhdukjen e Lëvizjes Islame, e cila vjen gjithnjë e në rritje në botë. Në një deklaratë të botuar nga gazetata amerikane të datës 19 nëntor 1979, ai kërkoi nga qeveria e Shteteve të Bashkuara që të dilte me një deklaratë zyrtare ku t'i cilësonte të gjithë islamistët e lëvizjeve islame si të dalë jashtë ligjeve ndërkombëtare dhe i premtoi zgjedhësve se ai do t'i dëbonte të gjithë ata islamistë nga çdo vend i botës nëse do të fitonte në zgjedhje. Por për fatin e tij të keq nuk mundi të fitojë.

Revista "Xhuish Kronikëll" (Jewish Chronicle), revista çifute me përhapje më të gjerë në Evropë, në një nga numrat e saj të botuar javën e parë të janarit 1979, botoi një artikull ku thuhet:

"Është detyra e të gjithë ekspertëve të strategjisë politike në vendet e civilizimit perëndimor dhe ato të kampit komunist që të jenë shumë të vëmendshëm ndaj rrezikut që paraqesin rrymat fanatike islamike të përhapura në të gjitha vendet arabe dhe shumicën e vendeve islamike, të cilat synojnë të ringjallin nocionin e xhihadit në rrugën e Allahut dhe që luftojnë shumë për t'i bindur arabët dhe Muslimanët e tjerë që të kthehen tek mësimet e Islamit". Më poshtë ajo vazhdon: "As bota perëndimore dhe as Bashkimi Sovjetik nuk mund të qëndrojnë duarkryq përpara këtij rizgjimi, i cili nëse keqdrejtohet nga grupimet fanatike islamike, mund të çojë jo vetëm në shkatërrimin e Izraelit, por edhe në destabilizimin e një pjese të madhe të botës, nga i cili nuk do të shpëtojë as civilizimi perëndimor dhe as ai komunist".

Në një intervistë me ish-ambasadorin izraelit pranë Kombeve të Bashkuara, Haim Hercog, të botuar në gazetën "Dhë Xheruzalem Post" (The Jerusalem Post) të datës 25 shtator 1978, ky i fundit thotë:

"Sot jemi dëshmitarë të një dukurie të çuditshme që të tërheq vëmendjen, e cila mbart një rrezik për të gjithë shoqërinë perëndimore. Kjo dukuri është kthimi i lëvizjeve islamike, të cilat e konsiderojnë vetveten si armike të çdo gjëje që është perëndimore dhe e konsiderojnë intolerancën kundër çifutëve si detyrë të shenjtë".

Këta armiq që komplotojnë kundër nesh sot dhe të cilët më parë bënë plane për shkatërrimin që në embrion të Islamit, besimeve të tij, strukturës politike të tij, familjes, të vërtetave të ekzistencës dhe moraleve islame për të ngritur mbi të shtetin çifut botëror, janë po ata që sot bëjnë plane, së bashku me shumë grupime të krishtera, për shkatërrimin e Xhamisë El-Aksa dhe Xhamisë së Shkëmbit, me qëllim ndërtimin në vendin e tyre të Tempullit të Tretë çifut. Përpara Islamit dhe pas tij, ata kanë pasur një histori të gjatë me këtë vend të shenjtë. Por cila është kjo histori? Ejani që të njihemi me të përmes fakteve historike.

FAKTE PËR XHAMINË EL-AKSA DHE TOKËN E SHENJTË PËRPARA DËRGIMIT TË MUHAMMEDIT XHAMIA EL-AKSA DHE SHKËMBI

Xhamia El-Aksa është emri islam i tempullit të lashtë që ndodhet në tokën e Palestinës. Kjo xhami është e dyta që ndërtoi Ibrahim (a.s.) pas Xhamisë së Shenjtë (Qabes). Transmetohet nga Ebu Dherr El-Gafari (r.a.) se ai ka thënë: "Thashë: -O i Dërguar i Allahut, cila xhami është ndërtuar e para mbi tokë? Ai tha: -Xhamia e Shenjtë. -Po pas saj? Ai tha: -Xhamia El-Aksa. I thashë:

- Sa kohë ka ndërmjet tyre? Ai tha: -Dyzet vjet".

Te dijetarët dhe historianët, termi "Xhamia El-Aksa" nuk nënkupton vetëm ndërtesën ekzistuese që njihet me këtë emër. E gjithë pjesa që ndodhet brenda murit të madh me shumë dyer, nga pikëpamja e Sheriatit, konsiderohet si xhami, drejt së cilës lejohet dhe inkurajohet udhëtimi, si dhe shumëfishohet vlera e namazeve. Në të ndodhet edhe Xhamia e Shkëmbit me kubenë e florinjte të ngritur mbi ndërtesën e vyer. Sa herë që përmendet emri i Xhamisë El-Aksa, mendja na shkon te kjo kube. Shkëmbi ka një histori të pasur. Në të u fal Ademi (a.s.); Ibrahim (a.s.) e mori atë për faltore dhe altar; Ja'kubi (a.s.) ndërtoi mbi të xhaminë e tij pasi pa një shtyllë drite sipër tij; Jushua Ibn Nuni (a.s.) ngriti mbi të Kubenë e Kohës ose Çadrën e Mbledhjes, të cilën e bëri Musai (a.s.) gjatë endjes nëpër shkretëtirë për të marrë në të shpalljen hyjnore; pranë tij Davudi (a.s.) ndërtoi mihrabin e tij; në të Sulejmani (a.s.) ngriti tempullin e madh që njihet me emrin e tij për adhurimin e Allahut dhe nga ky shkëmb, Muhamedi (s.a.v.s.) u ngjit në qiell natën e Israsë dhe Mi'raxhit.

I pari që ndërtoi mbi të një xhami në epokën islame ishte Halifi emevij Abdulmelik ibn Mervan (73-86 hixhri) (685-691 e.r.). Dhe tani po japim një paraqitje të shkurtër të epokave nëpër të cilat ka kaluar Toka e Shenjtë dhe Tempulli i lashtë përpara dërgesës së Muhamedit (s.a.v.s.).

1. NË KOHËN E IBRAHIMIT (A.S.)

Kjo periudhë përfaqëson fazën më të hershme të ndërtimit të Xhamisë El-Aksa. Pasi u nda nga i ati dhe populli i tij, Ibrahim (a.s.) emigroi nga Iraku për në tokën e Shamit, e cila tani u bë atdheu i tij i ri. Aty ai ndenji për ca kohë dhe më pas zbriti në tokën e Egjiptit pas një thatësire të madhe që pllakosi Shamin. Me vonë u rikthye në Sham, pasi faraoni i atëhershëm deshi të vinte dorë mbi granatën e tij Sarën. Me vete mori edhe Haxheren, një aristokrate të zënë robëreshë nga faraoni, të cilën ky i fundit ia dhuroi Sarës, që nga ana e saj ia dha Ibrahimit për të lindur fëmijë me të. Prej saj Allahu i Lartësuar i dha Ismailin (a.s.). Me urdhrin e Allahut (xh.sh), Ibrahim e la Haxherin dhe Ismailin e vogël në tokën e Mekës së Nderuar, ashtu siç e tregon edhe Kur'ani Fisnik, në një luginë të shkretë dhe pa asnjë bimësi. Pas ca kohësh, së bashku me të birin, Ismailin, ai ndërtoi Qaben e Lavdishme dhe më pas u kthye në Palestinë, ku ndërtoi Xhaminë El-Aksa dyzet vjet pas ndërtimit të Xhamisë së Shenjtë siç transmetohet në hadithin e Ebu Dherr El-Gafariut (r.a.).

2. NË KOHËN E IS-HAKUT (A.S.) DHE JA'KUBIT (A.S.)

Disa vjet pas lindjes së Ismailit, Ibrahimit i lindi Is-haku (a.s.), të cilin Allahu (xh.sh) e zgjodhi të dërguar siç kishte zgjedhur më parë edhe Ismailin. Is-hakut i lindën dy djem: Ja'kubi dhe Esau. Ja'kubi u zgjodh si i dërguar, ndërsa Esau jo. Ja'kubi njihet gjithashtu edhe me emrin Israil (Izrael); prej tij kanë rrjedhur bijtë e Izraelit (çifutët). Në kohën e tij, po mbi Shkëmb, u rindërtua përsëri Tempulli, pasi që ndërtesa e Ibrahimit ishte vjetruar.

3. NË KOHËN E MUSAIT (A.S.)

Në fund të jetës së Ja'kubit, bijtë e Izraelit u larguan nga Palestina dhe shkuan në Egjipt me ftesën e Jusufit (a.s.), birit të Ja'kubit. Në Egjipt ata qëndruan derisa dolën prej tij nën udhëheqjen e Musait (a.s.), pas përndjekjeve dhe poshtërimeve që u bënte faraoni i tij. Dalja e tyre nga Egjipti në kohën e profetit më të madh të tyre, përbën realizimin e ëndrrës së madhe të tyre për rikthimin në Tokën e Shenjtë nga e cila kishin ikur në kohën e Ja'kubit (a.s.). Por ata refuzuan që të luftonin në xhihad kundër armiqve që kishin zënë Tokën e Shenjtë pas ikjes së tyre, ndaj u dënuan që të endeshin dyzet vjet në shkretëtirën e Sinait. Ndonëse digjeshin nga malli për t'u rikthyer atje, frika i ndalonte që të luftonin për ta rifituar edhe një herë Tokën e Shenjtë. Në këtë kohë vdiqën Musai dhe Haruni, që shpresonin shumë të hynin në të, por kur iu

bë e qartë se nuk do të arrinin të hynin me këtë brez frikacakësh, iu lutën Allahut (xh.sh) që të varroseshin afër saj sa një të hedhur guri dhe ajo dëshirë iu plotësua.

4. NË KOHËN E JUSHUA IBN NUNIT (A.S.)

Pas Musait (a.s.), profetësinë e trashëgoi Jushua ibn Nuni, djaloshi që përmendet në suren El- Kehf të Kur'anit dhe profetësia e tij është vërtetuar prej Sunetit. Ai u urdhërua që, së bashku me ata që kishin mbetur nga bijtë e Izraelit, të dilte nga shkretëtira për të shkuar në Tokën e Shenjtë që u ishte premtuar vetëm besimtarëve. Jushua u nis me brezin e dytë dhe ata pak që kishin mbetur nga brezi i parë i dënuar të endej nëpër shkretëtirë dhe rrethoi BejtulMakdis (Kudsin). Dielli ishte në të perënduar kur Jushua ishte gati në të marrë të qytetit, ndaj ju lut Allahut që ta ndalonte diellin që të mos perëndonte sa të merrte qytetin dhe Allahu iu përgjigj lutjes së tij. Në krye të ushtrisë së tij, ai u fut si fitimtar në Tokën e Shenjtë dhe mbi Shkëmb ngriti kubënë e Musait (a.s.). Bijtë e Izraelit filluan të faleshin drejt saj dhe kur ajo u prish, vazhduan të faleshin drejt Shkëmbit. Ky shkëmb ishte kibleja e të dërguarve deri në kohën e Muhamedit (s.a.v.s.).

5. PAS KOHËS SË JUSHUA IBN NUNIT (A.S.)

Pas kohës së Jushua ibn Nunit, bijtë e Izraelit kaluan nëpër tre epoka:

- Në epokën e gjykatësve, e cila zgjati 400 vjet dhe gjatë së cilës sunduan gjykatës nga të dymbëdhjetë fiset.
- Në epokën e mbretërve, në të cilën sundimin e bijve të Izraelit e morën në dorë mbretërit, pas dobësimit të ndikimit të gjykatësve.
- Në epokën e dobësimit, shpërbërjes dhe rënies. Epoka më e begatë e të gjitha kohërave ishte epoka e mbretërve, e cila erdhi pas asaj të gjykatësve. Pasi që gjykatësit nuk mundën më të drejtojnë punët e bijve të Izraelit, armiqtë filluan të lakmojnë tokën e tyre dhe dalëngadalë shtrinë sundimin e tyre mbi të gjithë vendin. Atëherë bijtë e Izraelit iu drejtuan një profeti të tyre duke kërkuar prej tij që Allahu të dërgonte nga mesi i tyre një mbret që të luftonin së bashku me të në rrugën e Allahut siç tregon Kur'ani i Shenjtë në suren El- Bekare ajetet 246-251. I Dërguari iu përgjigj kërkesës së tyre dhe Taluti u caktua si mbret. Davudi ishte njëri nga ushtarët e tij. Nga ushtria kundërshtarë, e cila asokohe ishte filistine (palestineze), doli Xhaluti dhe ftoi në duel një luftëtar të ushtrisë

tjetër. Atëherë u paraqit Davudi (a.s.) që triumfoi mbi Xhalutin duke e vrarë atë. Kjo gjë ia lehtësoi shumë rrugën Davudit dhe pas Talutit, ai u bë mbreti i dytë i bijve të Izraelit. Pushteti filloi të trashëgohej brenda familjes së tij. Davudi çliroi Qytetin e Shenjtë (Kudsin) ose siç quhet nga bijtë e Izraelit, Oroshilimin, Qytetin e Paqes.

6. NË KOHËN E DAVUDIT (A.S.)

Kur çliroi qytetin e Kudsit në vitin 977 p.K, Davudi dërgoi në të edhe Tabutin (arkën), në të cilin kishte disa gjëra që kishin mbetur nga Musai dhe Haruni siç e tregon edhe Kur'ani i Shenjtë. Në Qytetin e Shenjtë, ai përgatiti një truall të rrafshët dhe të gjerë për ndërtimin mbi të të Tempullit të Shenjtë (Xhamisë El-Aksa) dhe grumbulloi lëndët e ndërtimit për këtë qëllim, por e ndjeu se nuk do të jetonte aq gjatë sa ta shihte atë të përfunduar. Ndaj ia la amanet këtë të birit, Sulejmanit (a.s.).

7. NË KOHËN E SULEJMANIT (A.S.)

Sulejmani (a.s.) lindi dhe u rrit në Kuds. Pas vdekjes së të atit, trashëgoi fronin e mbretërisë. Sundimi i tij zgjati dyzet vjet 963-923 p.K. Komentatorët e Kur'anit thonë se për dyzet ditë ai u zhduk, pastaj u kthye shpejt dhe filloi ndërtimin e Tempullit të Shenjtë, një ndërtesë gjigante dhe luksoze që i shkonte për shtat një profeti-mbret si ai që i ishte dhënë çdo gjë, bile i ishte dhënë ajo që nuk i ishte dhënë askujt më parë, një sundim që nuk do ta ketë askush pas tij. Ndonëse Sulejmani nuk ishte ndërtuesi i parë i këtij tempulli (ai veçse ndërtoi mbi të një ndërtesë të madhe dhe të bukur), ky tempull u bë i njohur me emrin e tij, për shkak të madhësisë së formës së tij. Siç thotë edhe Ibni Tejmije (rahmetullahi alejhi): "Xhamia El-Aksa ka qenë që në kohën e Ibrahimit (a.s.), porse Sulejmani (a.s.) e ndërtoi në mënyrë madhështore".

8. PAS KOHËS SË SULEJMANIT (A.S.)

Pas vdekjes së Sulejmanit, mbretëria e tij u nda në dy pjesë: në mbretërinë e Jugut (Jehuda ose Judea) me kryeqytet Oroshilimin dhe në mbretërinë e Veriut (Izraelin) me kryeqytet Nablusin ose Shikimin. Pjesa më e madhe e fiseve të bijve të Izraelit ndodheshin në mbretërinë e Veriut, e cila kishte sipërfaqe më të madhe se ajo e Jugut.

9. RËNIA E DY MBRETËRIVE DHE SHKATËRRIMI I PARË I TEMPULLIT

Në vitin 721 p.K, Sargoni, mbreti i Ashurisë, e zhduku fare mbretërinë e Izraelit, zuri rob të fundmin mbret të saj, dëboi popullin e Izraelit dhe vendosi në të një guvernator të tijin.

Në vitin 608 p.K, faraoni i atëhershëm i Egjiptit sulmoi mbretërinë e Jehudës, e cila nuk kishte rënë akoma, e pushtoi atë dhe vazhdoi përparimin e tij derisa pushtoi edhe mbretërinë e Izraelit, të cilën e kishin pushtuar më parë ashurasit. I zemëruar nga kjo gjë, mbreti i Babilonisë, Nabukodonosori I, i cili e kishte shtrirë sundimin e tij edhe mbi Ashurinë, sulmoi Palestinën në të dyja pjesët e saj, Izraelin dhe Jehudën, dërrmoi faraonin dhe i rimori të dy mbretëritë. Në vitin 587 p.K, ai shkatërroi Xhaminë El-Aksa dhe mori me vete si skllavër në Babiloni gati të gjithë bijtë e Izraelit. Disa prej tyre u arratisën për në Egjipt dhe vende të tjera. Kjo periudhë njihet në histori me emrin periudha e skllavërisë babilonase. Në Kur'anin e Shenjtë, kjo periudhë përmendet në fillimin e sures El-Isra:

"Ne u kumtuam në libër Beni Israilëve: Ju do të bëni shkatërtime dy herë në tokë dhe do të tejkaloni duke bërë zullum të madh. Kur erdhi koha e premtimit të parë, Ne dërguam kundër jush njerëz Tanë, që ishin të fuqishëm e të ashpër dhe ata hulumtuan përreth vendit. E ai (ndëshkim) ishte vendim i prerë."⁴

10. KOHA E KTHIMIT NGA ROBËRIA DHE RINDËRTIMI I TEMPULLIT

Pas rënies së mbretërive të Izraelit dhe Jehudës, mbreti i persianëve, Kiri, pushtoi Babiloninë dhe si rrjedhojë, nën sundimin e tij u fut edhe toka e Jehudës. Ky mbret i lejoi bijtë e Izraelit që të ktheheshin në tokën e Jehudës dhe që nga ajo kohë, atyre iu vu emri jahudij (çifutë) dhe fesë së tyre jahudizëm. Ndaj, çdo njeri që përqafon fenë çifute quhet jahudi (çifut), ndonëse mund të mos i përkasë bijve të Izraelit. Sapo u lejuan nga mbreti Kir që të ktheheshin, çifutët vendosën të rindërtonin Qytetin e Shenjtë dhe

⁴ Kur'ani: Isra',4-5.

Tempullin. Dhe ashtu bënë. Por pozita e tyre në Tokën e Shenjtë mbeti ajo e një populli pa shtet, sepse në tokën e Palestinës sundonte Persia.

11. ROMAKËT PUSHTOJNË TOKËN E SHENJTË

Pas një periudhe, gjatë së cilës u alternuan sundimet persiane, maqedonase (Aleksandri i Madh) dhe egjiptiane (dinastia e Ptolemejve), i erdhi radha romakëve të sulmonin Tokën e Shenjtë në vitin 63 p.K dhe ta pushtonin atë. Ata vendosën si mbret Herodin, i cili u përpoq që t'i kthente gjërat në rrjedhën e tyre të natyrshme dhe t'i pajtonte çifutët. Pas vjetërimit të Tempullit, në vitet 20-18 p.K, ai e restauroi atë dhe riktheu ritualet e kohës së Sulejmanit. Tempulli vazhdoi në këtë gjendje derisa erdhi koha e profetit të Allahut, Zekerijas dhe birit të tij, Jahjasë, si dhe Isait, birit të Merjemes (alejhimes-selam).

12. TEMPULLI NË KOHËN E ZEKERIJAS (A.S.) DHE JAHJASË (A.S.)

Edhe në kohën e Zekerijas, Xhamia El-Aksa ishte në këmbë. Në Kur'anin e Shenjtë përmendet se gruaja e Imranit iu lut Allahut (xh.sh) që t'i jepte një djalë të drejtë që t'ia përkushtonte shërbimit të Tempullit, por Allahu i dha Merjemen, bijën e Imranit, e cila u rrit në kujdesin e Zekerijas që ishte i pari i Tempullit. Në mihrabin e tij, ai iu lut Allahut të Lartësuar që t'i jepte pasardhës të drejtë dhe Allahu i dha Jahjanë (a.s.), ndonëse Zekerija ishte i kaluar në moshë dhe nuk kishte pasur fëmijë. Në këtë kohë Merjemja lindi Isain (a.s.), robin e Allahut, të Dërguarin e Tij.

13. TEMPULLI NË KOHËN E ISAIT (A.S.)

Kur u rrit Isai (a.s.), Allahu (xh.sh) e zgjodhi dhe i dha profetësinë. Isai (a.s.) e përdori Xhaminë El-Aksa si minber për thirrjen tek Allahu, në një kohë kur u shtuan krimet e bijve të Izraelit dhe arritën deri aty sa të prekej edhe shenjtëria e kësaj xhamie të shenjtë kur çifutët e kthyen në një treg për sarafët dhe fajdexhinjtë, si dhe vend për lojëra me pëllumba. Atëherë ai i paralajmëroi se do të privoheshin nga ky tempull, shenjtërinë e të cilit nuk po e respektonin, nëse nuk hiqnin dorë nga krimet e tyre. Por ata nuk ia vunë veshin. Ai i njoftoi atë që i kishte zbritur nga Allahu se ky tempull do të shembej dhe se në të nuk do të mbetej gur mbi gur. Në atë kohë, shpirti kriminel i çifutëve bëri që ata të vrasin Zekerijan (a.s.) duke e prerë atë me sharrë dhe më pas të birin, Jahjanë, duke ia dorëzuar mbretit zullumqar Herod, pasi nuk pranoi të jepte vendim

fetar (fetva) për lejimin e martesës së mbretit më një nga të afërmet e tij, me të cilën nuk i lejohej martesa. Me këto veprime, u realizua profecia e përhapjes së prishjes dhe korrupsionit mbi tokë për herë të dytë; kjo gjë përmendet në fillimin e sures El-Isra, siç thonë shumë nga komentatorët e Kur'anit.

14. SHKATËRRIMI I DYTË I TEMPULLIT

Pas krimeve të njëpasnjëshme të çifutëve: vrasjes së Zekerijas dhe Jahjasë, si dhe planit që bënë për vrasjen e Isait (paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë këta profetë), profecia e Isait (a.s.) u realizua kur njëri nga perandorët e Romës, Titusi, në vitin 70 pas.K, e dogji Qytetin e Shenjtë dhe shkatërroi Xhaminë El-Aksa, nga e cila nuk mbeti gur mbi gur ashtu siç kishte paralajmëruar Isai (a.s.). Kështu ndodhi shkatërrimi i dytë i Tempullit, pas shkatërrimit të parë të tij nga Nabukodonosori. Pikërisht për këtë shkatërrim bëhet fjalë në ajetin Kur'anor:

"Dhe kur erdhi koha e fundit (Ne i lejuam armiqtë tuaj) që t'ua shëmtojnë fytyrat tuaja, të hyjnë në Xhaminë (El-Aksa) ashtu siç hynë herën e parë dhe të shkatërrojnë rrënjësisht atë që arritën."⁵

15. NGRITJA E NJË TEMPULLI PAGAN NË VEND TË XHAMISË EL-AKSA

Pas shkatërrimit që i bëri Titusi Xhamisë El-Aksa në vitin 70 pas.K, erdhi një tiran tjetër, Adriani, i cili fshiu të gjitha shenjat e Qytetit të Shenjtë dhe i zhduku gërmadhat e Tempullit, për të ndërtuar mbi të një tempull pagan, të cilin ia kushtoi Jupiterit, zotit të zotave sipas besimeve të romakëve paganë.

16. SHKATËRRIMI I TEMPULLIT PAGAN

Në kohën kur ndërtuan tempullin e Jupiterit, romakët nuk kishin hyrë në fenë e krishterë. Tempulli mbeti në formën e tij pagane deri kur toka e Palestinës ra nën ndikimin e krishterë, në kohën e perandorit Konstantin, prishësit të krishterimit dhe futësit në të të dogmës së Trinisë. Të krishterët e prishën atë që në themel. Kështu Toka e Shenjtë mbeti për shumë kohë në sundimin e të krishterëve trinitarianë pa asnjë tempull ku të mund të njësohej dhe të adhurohej Allahu i Lartësuar.

⁵ (El-Isra: ajeti 7).

17. FUNDI I HEGJEMONISË ÇIFUTE DHE ASAJ TË KRISHTERË MBI TOKËN E XHAMISË EL-AKSA

Pas prishjes dhe korrupsionit të jehudizmit dhe krishterimit, në Tokën e Shenjtë mbetën vetëm pak besimtarë të vërtetë të Allahut dhe vendi i Xhamisë mbeti pa asnjë ndërtesë të ngritur mbi të gjatë gjithë periudhës së sundimit të romakëve të krishterë deri në ardhjen e epokës së profetësisë së fundit. Në kohën e sundimit të perandorit romak Heraklit (610-641 pas.K), përpara emigrimit të Muhamedit (s.a.v.s.) nga Meka në Medinë, ndodhi Israja dhe Mi'raxhi, udhëtimi natën i të Dërguarit (s.a.v.s.) nga Xhamia e Shenjtë në atë El-Aksa, si dhe ngjitja e tij në qiell. Në atë kohë, në vendin e Xhamisë nuk kishin mbetur veçse ca rrënoja të murit rrethues, nga të cilat edhe Muri i Burakut, në të cilin Muhamedi (s.a.v.s.) lidhi Burakun. Ndodhia e Israsë dhe Mi'raxhit lajmëronte se për Tokën e Shenjtë dhe Xhaminë El-Aksa po fillonte një epokë tjetër, ajo islame, nën hijen e fesë dhe mesazhit të fundit hyjnor. Kështu u mbyll dosja e çifutëve dhe të krishterëve për sa i përket kujdesit dhe ruajtjes së Xhamisë dhe Tokës së Shenjtë. Tani ato kishin kaluar nën mbrojtjen, kujdesin dhe trashëgimin e Ummetit Islam, trashëgimtarit të mesazheve dhe vendeve të shenjta.

TOKA E SHENJTË DHE XHAMIJA EL-AKSA NËN HIJEN E ISLAMIT

Pas kalimit të tyre në trashëgimin e Ummetit Islam, i cili trashëgoi statusin e kombit të zgjedhur pas bijve të Izraelit, Toka e Shenjtë dhe Xhamia El-Aksa zunë një vend të lartë dhe të respektuar në zemrat e Ummetit të Muhamedit (s.a.v.s.). Ato janë në zemrat e çdokujt që ka një zemër muslimane. Islami i shtoi këtyre vendeve të shenjta edhe më shumë shenjtëri dhe lavdi. Në Kur'anin e Shenjtë, Toka e Shenjtë përshkruhet me cilësitë e bekimit, pastërtisë dhe shenjtërisë siç shikohet në ajetet e mëposhtme:

"O populli im, hyni në tokën e Shenjtë, të cilën jua premtoi Allahu..."⁶

"E atij popullit që ishte i nënshtuar, i dhamë në trashëgim lindjen dhe perëndimin e tokës që Ne e bekuam..."⁷

"Pa të meta është Ai që robin e vet e kaloi në një pjesë të natës prej Xhamisë së Shenjtë (Qabes) në Xhaminë më të Largët (El-Aksa), rrethinën e së cilës e kemi bekuar..."⁸

"Dhe Ne e shpëtuam atë dhe Lutin në tokën që e kemi bekuar për njerëzit"⁹

"Ndërsa Sulejmanit (ia nënshtroam) erën e fortë që sipas dëshirës së tij ecte me të deri tek toka, të cilën e kemi bekuar..."¹⁰

"Dhe kur arriti tek ai (zjarr) nga ana e djathtë e luginës së atij vendi të bekuar me pemë, u thirr: "O Musa, s'ka dyshim se Unë jam Allahu, Zoti i botrave."¹¹

"Dhe, në mes tyre dhe mes fshatrave të bekuara (në Sham), ju bëmë fshatra të njëpasnjëshme dhe ju bëmë udhëtim të përshtatshëm..."¹²

⁶ Kur'ani: Maide, 21.

⁷ Kur'ani: A'raf, 137.

⁸ Kur'ani: Isra, 1.

⁹ Kur'ani: Enbija, 71.

¹⁰ Kur'ani: Enbija, 81.

¹¹ Kur'ani: Kasas, 30.

¹² Kur'ani: Sebe', 18.

Shenjtëria e këtyre vendeve tregohet edhe nga betimi që bën Allahu i Lartësuar për to, së bashku me të tjera vende, siç thuhet në tefsirin e Ibn Kethirit:

"Pasha fikun dhe ullirin! Dhe (kodrën) Turi Sininë! Dhe këtë qytet të sigurt!"¹³

Në ajetin Kur'anor, në të cilin flitet për Isain (a.s.) dhe nënën e tij, siç thonë komentatorët e Kur'anit Katade, Kaab dhe Sudijj, nënkuptohet Toka e Shenjtë:

"...dhe i vendosëm që të dy në një rrafshnaltë me ujë rrjedhës"¹⁴

Në fjalën e Allahut (xh.sh):

"Dhe vija veshin thirrësit kur thërret nga një vend i afërt"¹⁵

sipas tefsirit "Fet-hul Kadir" të imam Sheukanit, ky thirrës është Israfili që thërret nga Shkëmbi i Xhamisë El-Aksa.

Në fjalën e Allahut (xh.sh):

"(Ajo dritë) Është në shtëpitë (xhamitë) që Allahu lejoi të ngrihen, e që në to të përmendet emri i Tij..."¹⁶

Ikrima thotë se ato janë katër xhamitë: Qabeja, Xhamia Kuba', Xhamia e Profetit (s.a.v.s.) dhe Xhamia e Bejtul-Makdisit.

Shumë komentatorë thonë se në fjalën e Allahut të Lartësuar:

"E kush mund të jetë më mizor se ai që, në shtëpitë e Allahut pengon të përmendet emri i Tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre..."¹⁷ është për qëllim Xhamia El-Aksa.

Ibn Tejmije thotë: "Kur'ani dhe Syneti i të Dërguarit (s.a.v.s.), së bashku me atë që është transmetuar nga të dërguarit e mëparshëm, atë që mësohet përmes shqisave, mendjes dhe zbulimeve të të diturve, tregojnë që fillimi i krijimit dhe gjithçkaje nisi nga Meka, (Ummul-Kura)

¹³ Kur'ani: Tin, 1-3.

¹⁴ Kur'ani: Mu'minun, 50.

¹⁵ Kur'ani: Kaf, 41.

¹⁶ Kur'ani: Nur, 36.

¹⁷ Kur'ani: Bekare, 113.

Nëna e Qyteteve. Në Mekë filloi mesazhi i Muhamedit (s.a.v.s.), drita e të cilit u përhap dhe përfshiu të gjithë botën. Allahu e bëri atë vend drejtimi për të gjithë njerëzit; drejt saj ata falen dhe në të bëjnë haxhin. Në Mekë ata realizojnë interesat e tyre të kësaj bote dhe botës tjetër. Në fillimin e tij, Islami ishte më i fortë në Hixhaz. Argumentet e përmendur tregojnë se sundimi i profetësisë është në Sham dhe se tubimi i njerëzve (Hashri) do të jetë në të. Në kohën e fundit, Islami do të jetë më i fortë në Sham. Ashtu siç është Meka më e mirë se Xhamia El-Aksa, ashtu edhe brezat e parë të Ummetit janë më të mirë se ato të fundit. Në kohën e fundit, çdo gjë do të përqendrohet në Sham, sepse edhe Israja (udhëtimi natën i të Dërguarit a.s.) ndodhi nga Xhamia e Shenjtë (Qabeja) në Xhaminë El-Aksa."

Udhëheqja si imam në namaz e të gjithë të dërguarve të tjerë në Natën e Israsë dhe Mi'raxhit është një konfirmim i qartë i asaj se Islami është fjala e fundit që Allahu i drejtoi njerëzimit, e cila u përsos me profetësinë e Muhamedit (s.a.v.s.), pasi të dërguarit e tjerë kishin shtruar më parë rrugën për një gjë të tillë. Në natën e Israsë u tregua qartë se, në shariatën e Allahut, ngjyrimi i fundit e Xhamisë El-Aksa ishte ai islam. Dhe Xhamia El-Aksa vazhdoi të jetë e lidhur pazgjidhshmërisht me Ummetin Islam, profeti i të cilit udhëhoqi në namaz të gjithë të profetët e tjerë.

Pa dyshim se udhëtimi natën i të Dërguarit (s.a.v.s.) për në Xhaminë El-Aksa dhe ngjitja prej saj në qiejt e lartë është argument i shkëlqyer për atë se çfarë statusi të lartë gëzon ajo tek Allahu (xh.sh); gjithashtu është argument që mbështet dhe vërteton thënien se Xhamia El-Aksa është pika e vetme nga ku mund të ngjitesh në qiell, prandaj edhe njerëzit tubohen në këtë tokë dhe prej saj nisen për në xhenet ose xhehenem.

Krahas ajeteve kur'anore të sipërpërmendura, ekzistojnë edhe një mori hadithesh profetike që tregojnë qartë vlerën, rangun dhe nderimin që i bëhet Xhamisë El-Aksa në fenë islame. Po paraqesim disa prej tyre:

1. Transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a.) se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë: "Nuk lejohet dhe inkurajohet udhëtimi (me qëllim vizite dhe adhurimi

në të) veçse në tre xhami: Xhaminë e Shenjtë (Qabenë), Xhaminë e të Dërguarit (s.a.v.s.) dhe Xhaminë El-Aksa".¹⁸

2. Transmetohet nga Enesi (r.a.) se i Dërguari (s.a.v.s.) ka thënë: "M'u dha Buraku dhe i hipa derisa arrita në Bejtul-Makdis. E lidha atë në hallkën ku i lidhnin (kafshët e tyre) edhe të dërguarit (e tjerë), pastaj hyra në Xhami dhe fala në të dy rekate. Pastaj u ngjita në qiell."¹⁹

3. Transmetohet nga Xhunade ibn Ebu Umeje El-Ezedij: Unë dhe njëri nga ensarët shkua tek njëri nga shokët e të Dërguarit (s.a.v.s.) dhe i thamë: "Na trego atë që ke dëgjuar nga i Dërguari i Allahut për Dexhalin". Dhe përmendi hadithin në të cilin thuhet: "Shenja e tij është se do të qëndrojë në tokë dyzet mëngjese. Sundimi i tij do të arrijë në çdo burim (oaz) me përjashtim të katër xhamive: Qabes, Xhamisë së të Dërguarit, Xhamisë El-Aksa dhe Turit."²⁰

4. Transmetohet nga Abdullah ibn Amr (r.a.) se i Dërguari (s.a.v.s.) ka thënë: "Kur përfundoi së ndërtuari ndërtesën e Bejtul-Makdisit, Sulejmani, biri i Davudit, i kërkoi Allahut tri gjëra: gjykim

që t'i ngjasonte gjykimit të Tij, sundim që të mos ta gëzonte askush pas tij dhe që kushdo që shkon në këtë xhami, me të vetmin qëllim që të falet në të, të pastrohet nga mëkatet e tij dhe të jetë aq i pastër sa ditën kur e lindi e ëma". I Dërguari vazhdoi e tha: "Sa për dy të parat, ju dhanë dhe shpresoj që t'i jetë dhënë edhe e treta."²¹

5. Transmetohet nga Mejmune, shërbëtorja e të Dërguarit (s.a.v.s.): I thashë të Dërguarit të Allahut: "Na trego për Bejtul-Makdisin". Tha: "Tokë e Mahsherit dhe Mensherit (tubimit të njerëzve Ditën e Gjykimit dhe dërgimit të tyre në xhennet ose xhehenem), shkoni dhe faluni në të, sepse një namaz atje është sa njëmijë namaze në çdo vend tjetër". I thashë: "Më trego, po sikur të mos mundem të shkoj atje?" Tha: "Atëherë dhuro vaj për ndriçimin e saj, sepse ai që vepron kështu është si ai që ka shkuar atje."²²

¹⁸ Transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi

¹⁹ Transmeton: Muslimi.

²⁰ Transmeton: Imam Ahmedi.

²¹ Transmeton: Imam Ahmedi dhe Ibn Maxhe.

²² Transmeton: Imam Ahmedi, Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe

6. Transmetohet nga Ebu Dherri (r.a.) që i Dërguari (s.a.v.s.) i tha atij: "O Ebu Dherr, çfarë do të bësh nëse të nxjerrin nga Medina?" I thashë: "Në gjërësinë dhe mirësinë e Allahut. Do të iki deri sa të jem prej pëllumbave të Mekës". Tha: "Çfarë do të bësh nëse të nxjerrin nga Meka?" I thashë: "Në gjërësinë dhe mirësinë e Allahut, (do të shkoj) në Sham dhe Tokën e Shenjtë". Tha: "Çfarë do të bësh nëse të nxjerrin nga Shami?" I thashë: "Atëherë, pasha Atë që të ka dërguar ty me të vërtetën, do ta vendos shpatën mbi qafën time."²³

7. Transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a.) se i Dërguari (s.a.v.s.) ka thënë: "Një grup nga Ummeti im do të vazhdojë të luftojë në dyert e Damaskut dhe përreth tij, në dyert e Bejtul-Makdisit dhe përreth tij, ata nuk i dëmton askush që i kundërshton, triumfatorë në të vërtetën derisa të bëhet Kiameti."²⁴

8. Transmetohet nga Ebu Derdai (r.a.) së i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë: "Ndërkohë që isha në gjumë kur pashë shtyllën e Librit që u mbart poshtë kokës sime sa që mendova se mos ikte me të. Shikimi im e ndoqi derisa u ngulit më Sham. Mbani mend, kur të ndodhin fitnet (sprovimet), imani do të jetë në Sham."²⁵

9. Transmetohet nga Ebu Havale El-Ezedij (r.a.): I Dërguari i Allahut më vendosi dorën mbi kokë, pastaj tha: "O Ebu Havale, nëse sheh që Hilafeti ka zbritur në Tokën e Shenjtë, atëherë (dije që) janë afruar tërmetet, belatë (sprovimet) dhe gjërat e mëdha. Dhe Kiameti atë ditë është më afër për njerëzit sa ç'është dora ime nga koka jote."²⁶

Nga këto hadithe që përmendëm më lart si dhe nga shumë të tjera që janë transmetuar për vlerën e Xhamisë El-Aksa dhe Tokës së Shenjtë, kuptojmë pozitën e lartë të tyre në Islam, gjë e cila ka bërë që ato të zënë një vend të madh në fletët e historisë islame që nga koha e Profetit (s.a.v.s.) deri në fundin e Hilafetit Islam.

²³ Transmeton: Imam Ahmedi.

²⁴ Transmeton: Ebu Jaala

²⁵ Transmeton: Imam Ahmedi.

²⁶ Transmeton: Imam Ahmedi, Ebu Davudi dhe Hakimi.

Ja një vështrim i shkurtër mbi historinë e Xhamisë El-Aksa dhe Bejtul-Makdisit nën hijen e Islamit.

1. NË KOHËN E TË DËRGUARIT (S.A.V.S.)

I Dërguari (s.a.v.s.) u ngjit në qiejt e lartë për të parë argumentet e mëdha të Zotit të tij dhe vendi nga ku u ngjit ishte Xhamia El-Aksa. Ngjarja e Mi'raxhit ishte një nderim i madh që Allahu i Lartësuar i bëri Profetit të lavdishëm, nga një vend i madh, në një natë të madhe. Edhe sikur në kohën e Profetit të mos kishte ndodhur asnjë gjë që do t'ia kishte shtuar nderimin këtij vendi, do të mjaftonte vetëm ngjarja e Mi'raxhit. Por e vërteta është se me Xhaminë El-Aksa u lidhën edhe shumë ngjarje që ndodhën në kohët profetike, kur i Dërguari (s.a.v.s.) e drejtoi vëmendjen e tij tek kjo xhami, pasi e nderoi dhe e madhëroi këtë vend të shenjtë. Shikimi i tij u drejtua nga Bejtul-Makdisi në Sham me të vetmin qëllim që ta pastronte atë nga politeizmi i krishterë, ashtu siç kishte pastruar më parë Mekën nga idhujt e politeizmit arab, duke hedhur kështu hapin e parë drejt qëllimit të madh, çlirimit të Tokës së Shenjtë.

Pasi i dërgoi letra Herakliut, perandorit të Bizantit, dhe Shurahbil ibn Amr El-Gassanit, sundimtarit të Basrës, (ky i fundit e vrau korrierin që i solli letrën) me anë të së cilave i ftonte ato në Islam, Muhamedi (s.a.v.s.) u bëri thirrje muslimanëve që të drejtoheshin në Sham. Thirrjes së tij iu përgjigjën tremijë luftëtarë të përgatitur që morën pjesë në betejën e Mu'ëtas. Në këtë betejë mbetën të vrarë të tre komandantët: Zejd ibn Harithi, Xhafer ibn Ebu Talib dhe Abdullah ibn Revaha. Pas vrasjes së tyre, flamurin e mori Halid ibn El-Velidi, "Shpata e Allahut", i cili ia doli që ta tërhiqte ushtrinë me rregull dhe disiplinë. Pas kësaj ngjarjeje, bizantinët filluan të mbledhin ushtri për të sulmuar Shtetin Islam. Ata donin që t'i jepnin fund përpjekjeve të muslimanëve për marrjen e Tokës së Shenjtë dhe të ruanin pozicionin drejtues që kishin në botën e krishterë. Por lajmet për përgatitjen e ushtrisë së krishterë, e cila synonte të jepte një goditje të përqendruar kundër Shtetit Islam, arritën në veshët e muslimanëve dhe Muhamedi (s.a.v.s.) i mobilizoi të gjithë Muslimanët për përballimin e këtij armiku fodull. Kjo ndodhi në vitin e nëntë të hixhretit. Përgatitja e kësaj ushtrie u bë në rrethana të vështira, ndaj edhe ushtria u quajt "Ushtria e Vështirësisë". Ajetet kur'anore që kanë zbritur për këtë luftë janë më të gjata se ato që kanë zbritur për luftërat e tjera ndërmjet Islamit dhe armiqve të tjerë. Në suren Tevbe flitet në shumë vende për lajmet dhe gjendjen e kësaj ushtrie. Dhe doli ushtria islame, e cila përbëhej nga

tridhjetëmijë luftëtarë, numër ky që nuk ishte arritur në asnjë ushtri islame më parë. Kur arritën në Tebuk, Muslimanët nuk gjetën asnjë shenjë që të tregonte se bizantinët ishin përgatitur për luftë. Duket se ata kishin preferuar t'i shmangeshin takimit me ushtrinë e re islame. Përfundimi i këtij operacioni qe për Muslimanët paqe dhe krenari. Së bashku me ta, i Dërguari u kthye në Medinë. Pasi kreu Haxhin e Lamtumirës dhe u kthye përsëri në Medinë, Muhamedi (s.a.v.s.) i urdhëroi Muslimanët që të përgatiteshin për të sulmuar bastionet e bizantinëve në tokat e Shamit dhe zgjodhi si komandant të kësaj ushtrie Usama ibn Zejdin (r.a.). Kjo ndodhi në kohën kur Muhamedi (s.a.v.s.) sapo kishte filluar të ankohej nga sëmundja që i mori edhe jetën më pas. Ushtria nën komandën e Usamës, i cili asokohe nuk i kishte mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, doli nga Medina dhe ngriti kampin në Xhurf, në periferi të Medinës. Në atë kohë, gjendja e Muhamedit (s.a.v.s.) u keqësua dhe shpirti i tij i pastër u ngjit tek Krijuesi i tij (xh.sh). Dhe ushtria vazhdoi të qëndronte në atë vend duke pritur se çfarë do të urdhëronte Allahu i Lartësuar.

2. NË KOHËN E EBU BEKR ES-SIDDIKUT (R.A.)

Ebu Bekri (r.a.) e zbatoi urdhrin e Muhamedit (s.a.v.s.) për dërgimin e ushtrisë së komanduar nga Usama në luftë kundër bizantinëve, duke mos ia vënë veshin atyre që e këshilluan ta përdorte këtë ushtri në luftë kundër renegatëve. Pasi fitoi mbi renegatët dhe dërgoi Usamën, i cili e arriti qëllimin e dëshiruar, Ebu Bekri e drejtoi vëmendjen tek përgatitja dhe dërgimi i një ushtrie të madhe islame në Sham, jo vetëm për të luftuar bizantinët, por për ta çliruar atë dhe për ta futur nën flamurin e Islamit. Përgatitjet për këtë ushtri të përbërë nga dymbëdhjetëmijë luftëtarë përfunduan shpejt dhe ajo u vu nën komandën e Halid ibn El-Velidit (r.a.), pasi që ky e kreu detyrën e tij në luftë kundër persianëve. Në luftën kundër romakëve morën pjesë shumë sahabë të Profetit (s.a.v.s.), prijës të ndritur të muslimanëve dhe trima të pashoq. Shenjat e fitores u dukën qartë kur ushtria muslimane çliroi një numër qytetesh në Palestinë, gjë që i hapi rrugën çlirimit të qytetit të Kudsit në kohën e Omerit (r.a.).

3. NË KOHËN E OMER IBN EL- HATTABIT (R.A.)

Omeri (r.a.) i vazhdoi më tej përgatitjet për çlirimin e Bejtul-Makdisit. Ai nisi drejt Qytetit të Shenjtë Ebu Ubejde ibn El-Xherahun (r.a.) në krye të pesëmijë kalorësve, duke i dërguar më pas atij pesëmijë luftëtarë nën komandën e Jezid ibn Ebu Sufjanit dhe më vonë, edhe pesëmijë të tjerë me në krye Shurahbil ibn

Hasenen. Të gjithë këto forca u bashkuan dhe ngritën rrethimin përreth Qytetit të Shenjtë për gati katër muaj, derisa banorët e tij kërkuan paqe me kusht që të vinte vetë Omeri (r.a.) për të marrë në dorëzim qytetin. Omeri iu përgjigj pozitivisht kësaj kërkesë dhe vendosi që të nisej drejt Ilijas (Kudsit të sotëm). Ai mbërriti atje në muajin Rexhep të vitit të gjashtëmbëdhjetë të hixhretit, në muajin e Israsë dhe Mi'raxhit, për ta çliruar nga prangat vendin ku Muhamedi (s.a.v.s.) udhëtoi në atë natë të lavdishme. Omer ibn El-Hatabi (r.a.) u fut në qytetin e Kudsit nga rruga e malit Mukebbir, i cili u quajt kështu, sepse kur hodhi vështrimin e tij mbi Qytetin e Shenjtë nga maja e këtij mali, Omeri (r.a.) madhëroi Allahun dhe së bashku me të, edhe të gjithë Muslimanët. Pasi hyri në qytet, Omeri (r.a.) u drejtua tek vendi i Xhamisë El-Aksa, hoqi të gjithë plehrat që kishin hedhur të krishterët mbi të dhe ndërtoi një xhami përpara Shkëmbit, duke e lënë këtë të fundit në pjesën e pasme të xhamisë.

4. NË KOHËN E EMEVIJVE

Pasi i vendosi punët në vijë, Muavija, biri i Ebu Sufjanit (r.a.), mori betimin si kalif në qytetin e Kudsit dhe zgjodhi Damaskun si kryeqytet të Kalifatit. Më pas, edhe Abdulmelik ibn Mervan e mori betimin si kalif në Bejtul-Makdis. Ky i fundit dha urdhër për ndërtimin dhe rregullimin e Qytetit të Shenjtë, proces që vazhdoi edhe gjatë sundimit të birit të tij, El-Velid ibn Abdulmelik, duke bërë që Kudsi të bëhej një nga qendrat më të mëdha të qytetërimit në shtetin islam. AbdulMelikut i hyri punës për ngritjen e një ndërtese të re në vendin e Xhamisë El-Aksa dhe ndërtimin e Xhamisë së Kubesë së Shkëmbit. Ai dha urdhër që për ndërtimin e tyre të përdroreshin taksat e haraxhit të shtatë viteve, të cilat vinin nga Egjipti. Kështu të dyja ndërtesat u ngritën në atë formë që kanë edhe sot.

Me të marrë pushtetin, kalifi i drejtë emmevij Umer ibn Abdulaziz kërkoi nga të gjithë guvernatorët e tij që të vizitonin Xhaminë El-Aksa dhe të bënin në të betimin për bindje ndaj tij dhe drejtësi ndaj njerëzve.

5. NË KOHËN E ABBASIJVE

Pas rënies së dinastisë emevije, për një periudhë të gjatë, Qyteti i Shenjtë dhe Xhamia El-Aksa kaluan nën kujdesin dhe mbrojtjen e shtetit abbasij (132-656 hixhri). Një kujdes dhe vëmendje të veçantë iu kushtua Xhamisë në kohën e kalifit Ebu Xhafer El-Mensur, i cili i urdhëroi të gjithë princat, guvernatorët dhe komandantët e tij që secili prej tyre të merrte përsipër ndërtimin e një portiku të Xhamisë, pasi disa pjesë të saj ishin shembur si pasojë e një tërmeti. Dhe ata

e ndërtuan atë më të fortë dhe më të bukur se ç'kishte qenë më parë. Në vitin 158 hixhri, kalifi El-Mehdi kreu një sërë rregullimesh dhe zgjerimesh të Xhamisë, të cilat i vazhdoi më tej kalifi El-Me'mun.

6. NË KOHËN E TOLONIJVE DHE IHSHIDIJVE

Gjatë sundimit të Tolonijve dhe Ihsidijve, Qyteti i Shenjtë qëndroi nën mbrojtjen dhe sigurinë e tyre. Më pas Kudsi ra nën sundimin e egër ubejdian, në kohën e sunduesit fatimij El-Muizz Lidinil-lah, kur komandanti i tij ushtarak Xhevher Es-Sakilij pushtoi Palestinën në vitin 969 hixhri. Këta sundimtarë që përqaftuan haptas medhhebin shiit punuan për afrimin e të krishterëve dhe çifutëve në Palestinë, duke lidhur krushqi me ta dhe duke nënshkruar marrëveshje me perandorinë e krishterë të Bizantit, gjë e cila solli rritjen dhe rigjallërimin e pranisë së krishterë në Qytetin e Shenjtë.

7. NË KOHËN E TURQVE SELXHUKË

Turqit selxhukë arritën për një farë kohe t'ia rrëmbejnë Kudsit nga duart fatimijve, armiqve të tyre tradicionalë, kur e pushtuan qytetin në vitin 465 hixhri-1071 p.K. Por fatimijtë arritën përsëri ta fusin në dorë, ndonëse jo për shumë kohë, sepse kryqtarët ua rrëmbyen nga duart atë aleatëve të tyre fatimij, të cilët qenë fajtorët kryesorë për katastrofën kryqtare që ndodhi në Palestinë.

8. RËNIA E KUDSIT NË DUART E PUSHTUESVE KRYQTARË

Selia Papnore e shfrytëzoi menjëherë thirrjen e Simonit II, patriarkut të Kudsit. Papa Urbani II i drejtua koncilin kishtar të Klementit në vitin 1095, duke bërë thirrje për fillimin e luftërave të shenjta kundër muslimanëve për t'i dëbuar ata nga Bejtul-Makdisi. Thirrjes së tij iu përgjigjën të gjithë mbretërit dhe princat feudalë në Evropën Qendrore dhe Perëndimore, sepse ky ishte një rast i mirë për realizimin e ëndrrës së tyre të vjetër për ngritjen e një perandorie të re në Lindje mbi gërmadhat e Perandorisë Romake, të cilën Muslimanët e kishin dërrmuar në fillimin e Islamit.

Dhe të krishterët iu përgjigjën thirrjes së Papës. Kudo filluan të binin kabanat e luftës. Kudsi ra në duart e të krishterëve pas dyzet ditë rrethimi dhe pas dështimit të shiitëve për ta mbrojtur atë, si dhe arratisë së komandantit të tyre, Iftiharud-devle dhe shpurës së tij. Ditën e xhuma, më njëzet e tre të muajit Shaban të vitit 492 hixhri, në kohën e sundimit të kalifëve fatimij El-

Mustealij Bil-lah dhe El-Mustadh-hir Bil-lah, Qyteti i Shenjtë ra në duart e adhuruesve të kryqit. Për herë të parë që nga ndriçimi i botës nga drita e Islamit, të krishterëve iu dha mundësia që t'i ngulnin muslimanëve thikën në zemër. Të dehur nga kjo fitore kaq e lehtë kundër një sundimtari mendjelehtë dhe kokëkrisur, ata u futën në qytet si të çmendur, duke mbjellë kudo frikë dhe shkatërrim. Egërsisë së tyre nuk i shpëtoi asnjë burrë, grua, plak apo fëmijë. Të gjithë u vranë pa asnjë dallim. Gjaku u derdh pa mëshirë. Kasaphana e tmerrshme vazhdoi gjatë gjithë ditës dhe natës së pushtimit. Në mëngjesin e ditës së dytë, kryqtarët hynë me forcë në Xhaminë El-Aksa, duke vranë të gjithë ata që ishin strehuar në të. Sheshi i Xhamisë u mbyt me gjakun e të pafajshmëve. Pas kësaj, Rajmondi, komandanti i kryqëzatës, u fut në sheshin e Xhamisë, duke çarë rrugën përmes kufomave dhe gjakut që i arrinte deri në gjunjë.

Për 91 vjet me radhë, Bejtul-Makdisi qëndroi në duart e kryqtarëve mizorë dhe gjakatarë, derisa Allahu i Lartësuar i dhuroi fitoren sulltanit dhe mbretit ngadhënjimtar, Salahudin Jusuf ibn Ejjubit, i cili ditën e dielë, më 15 Rexhep të vitit 583 hixhri, u drejtua drejt Kudsit dhe u vendos së bashku me ushtrinë e tij në perëndim të tij. Që andej, ai u shpërngul në anën veriore të qytetit ku ngriti kampin, duke iu prerë kryqtarëve të gjitha rrugët e komunikimit. Pasi e vendosi qytetin nën një rrethim të hekurt, Salahudini ngriti katapultat dhe filloi bombardimin e tij. Rrethimi përfundoi me dorëzimin e kryqtarëve, të xhumanë, ditën e njëzet e shtatë të muajit Rexhep të vitit 583 hixhri, pikërisht ditën kur ndodhi Israja dhe Mi'raxhi.

TOKA E SHENJTË DHE TEMPULLI NË MENDIMIN DHE NDJENJAT E ÇIFUTËVE

Tempulli i Shenjtë përfaqëson Xhaminë El-Aksa në periudhën përpara dërgimit të Muhammedit (s.a.v.s.), por çifutët nuk e pranojnë faktin se Tempulli, si një vend i shenjtë adhurimi, ka kaluar në trashëgiminë e Ummetit të fundit. Ata ngulin këmbë për rindërtimin e tij sipas fesë çifute, e cila tashmë është shndërruar në një fe të kotë pas devijimit që ndodhi në të dhe anulimit (nga zbritja e Kur'anit Fisnik) edhe të atyre pak ligjeve të vërteta që kishin mbetur akoma në të.

Rrëfimi për Tokën e Shenjtë dhe Tempullin ze një hapësirë të madhe në trashëgiminë e lashtë dhe mendimin e sotëm çifut. Në trashëgiminë e tyre të lashtë, dora e devijimit e ka tepruar kaq shumë në rrëfimin e tyre, aq sa një libër si Teurati dhe veçanërisht pesë librat e parë të saj, nuk janë gjë tjetër veçse një tregim i shumëgjyreshëm për Tokën e Shenjtë dhe Tempullin për sa i përket ligjeve, rritualeve, vendimeve dhe liturgjive të tyre.

Në kohën tonë, interesimi i çifutëve për Tokën dhe Tempullin nuk është më i vogël se ai në kohët e vjetra. Njëri nga personalitetet e tyre kryesore të kohës sonë, David ben Gurioni, ka lënë pas një shprehje, e cila përmbledh qëndrimin e tyre ndaj kësaj çështjeje: "Izraeli nuk ka asnjë vlerë pa Jeruzalemin (Kudsin), ndërsa Jeruzalemi nuk ka asnjë vlerë pa Tempullin". Pas tij këtë shprehje e ka përsëritur vend e pa vend edhe Menahem Begini. Tempulli ze tek çifutët një vend kaq të lartë sa që sot ata kanë marrë si emblemë të shtetit të tyre diçka që simbolizon atë. Ajo është emblema zyrtare e shtetit të Izraelit: ylli gjashtëcepësh i Davidit. Këtë yll e gjejmë në mes të flamurit izraelit, në kapelen dhe helmetën e ushtarit izraelit, në spaletat e tyre, me të të shkruar mbi trup ecin tanket, fluturojnë aeroplanët dhe raketat e tyre. Çifutët nuk patën turp kur e morën këtë simbol fetar si emblemë të shtetit të tyre të "përparuar", simbol që iu kujton atyre emrin e të parit që ndërtoi shtetin e quajtur Izrael, i cili ishte Davudi (a.s.), ashtu siç nuk patën turp më parë kur e quajtën këtë shtet me emrin e babait të tyre, Izraelit ose Ja'kubit (a.s.). Krerët e tyre nuk e kanë për gjë të këndojnë haptas në çdo mbledhje vargun e Teuratis, i cili gjoja vërteton të drejtën e tyre historike mbi Tokën e Shenjtë: "Këtë vend do t'ua jap pasardhësve të tu, nga lumi i Egjiptit (Nili) deri në lumin Euftrat"... (Zanafilla: 15/18). Bile këtë varg e kanë shkruar mbi podiumin e Knesetit (parlamentit)

izraelit. Dihet botërisht se Izraeli është shtet pa ndonjë kushtetutë të shkruar, sepse kushtetuta e tij më e lartë është Teurati, ashtu siç dihet se deri tani, ai nuk i ka përcaktuar vetvetes kufinj zyrtarë, për shkak se pret të gllabërojë të gjithë ato toka që Teurati i përcakton si toka të Izraelit.

Armiqtë tanë çifutë nisen të mbështetur nga një prapavijë fetare teuratike, në nivelin zyrtar dhe atë popullor, dhe nuk janë siç pandehin shumë njerëz, thjesht një grup ateistësh laikë që shfrytëzojnë fenë dhe e fusin atë në politikë vetëm për qëllime propagandistike. Jo! Ata nisen mbi baza fetare, ndonëse janë të zhveshur krejtësisht nga moralet dhe virtytet njerëzore. Nuk ekziston ndonjë lidhje e domosdoshme ndërmjet fesë dhe moralit, përveçse atëherë kur feja është e vërtetë dhe e praktikuar ashtu siç duhet. Por nëse feja është e pavlerë dhe e devijuar, nga do të merren shembujt dhe morali i mirë? Ndoshta kjo gjë që mund të duket vogëlsi, është shkaku i konfuzionit mendor që vihet re tek ata që e mohojnë faktin se çifutët e kohës sonë janë pasues të një kauze fetare.

Dhe tani të meditojmë mbi ndjenjat fetare të çifutëve që lidhen me Tokën e Shenjtë dhe Tempullin, të cilat i kemi marrë nga burimet e tyre të vjetra dhe të reja.

1. TEURATI DHE TEMPULLI

Që në librin e Zanafillës, i cili është libri i parë i Teuratit, fillon rrëfimi për premtimin hyjnor që Zoti i bëri Ibrahimit dhe pasardhësve të tij për t'u dhënë atyre Tokën e Shenjtë: "Këtë tokë do t'ua jap pasardhësve të tu, nga lumi i Egjiptit deri në lumin Euftrat"... (Zanafilla: 15/18)

Çifutët harrojnë me dashje se nga pasardhësit e Ibrahimit është edhe një komb tjetër, bijtë e Ismailit, dhe të cilëve u është premtuar se do të kenë pushtet dhe do të jenë të shumtë, ashtu siç është shkruar në Teuratin e tyre: "Mos u shqetëso për djalën e për skllaven tënde, Hagarën. Bëj ashtu siç thotë Sara, sepse me anë të Jichakut do të kesh pasardhësit që të kam premtuar. Unë do t'i jap shumë fëmijë birit të skllaves, që të bëhen një komb. Ai, gjithashtu, është biri yt". (Zanafilla: 21/12-13)

Teurati flet edhe për periudhën e hershme përpara se Ibrahimit të ndërtonte tempull në tokën e Shamit: "...E përshkuan vendin e Kanaanit, derisa arritën në

pemën e shenjtë të Moreut, pranë Shehemit. Atje Zoti iu shfaq Abrahamit dhe i tha: Unë do t'ua jap këtë vend pasardhësve të tu.

Pastaj Abrahami ndërtoi një altar për nder të Zotit, pikërisht në atë vend ku i ishte shfaqur Zoti. Që andej, ai shkoi drejt zonës kodrinore, në lindje të qytetit Bet-El. Atje ngriti çadrat në perëndim të Bet-Elit dhe në lindje të Ajit" ...
(Zanafilla: 12/6-8)

Gjithashtu Teurati tregon se si Ja'kubi (a.s.) ndërtoi një tempull në atë tokë: "Perëndia i tha Jaakovit: "Shko menjëherë në Bet-El dhe bano atje. Atje ndërto një altar për nderin tim, për nder të Perëndisë që t'u paraqit në vegim kur po ikje nga vëllai yt, Esau" (Zanafilla: 35/1).

Teurati përmend se eshtrat e Jusufit (a.s.) i çuan në Tokën e Shenjtë: "Eshtrat e Josefit (Jusufit), që izraelitët i kishin sjellë me vete nga Egjipti, u vendosën në Shehem, në tokën që Jaakovi (Ja'kubi) ua kishte blerë bijve të Hamorit." ...
(Joshua: 24/32) Më poshtë, ai rrëfen se konflikti ndërmjet Musait (a.s.) dhe faraonit të Egjiptit vërtitej rreth kërkesës së Musait për të marrë me vete bijtë e Izraelit që ta adhuronin Zotin në Tokën e Shenjtë në të cilën kishin qenë më parë: "Pastaj Mosheu (Musai) dhe Aharoni (Haruni) shkuan tek faraoni i Egjiptit e i thanë: "Zoti, Perëndia e Izraelit, thotë: "Lëre popullin tim të shkojë për të festuar një festë në shkretëtirë për nderin tim". "E kush është Zoti? - pyeti faraoni. - Përse ta dëgjosh dhe ta lejoj popullin e Izraelit të shkojë? Unë nuk e njoh Zotin dhe nuk do ta lejoj Izraelin të shkojë" (Dalja: 5/1-2). Teurati sqaron se Musai (a.s.) u urdhërua që të ndërtonte një kube, e cila ishte Tenda e Tubimit në të cilën zbriste Teurati, dhe ta merrte me vete në Tokën e Shenjtë. Kur e pa se nuk ia doli t'i bindte bijtë e Izraelit që të luftonin për t'u futur në Tokën e Shenjtë, nga dashuria e madhe që kishte për të, Musai (a.s.) u lut që të vdiste pranë saj: "Po atë ditë, Zoti i tha Mosheut: "Shko tani në malësinë e Avarimit që është atje tej dhe hip në malin Nevo, që gjendet në vendin e Moavit, përballë Jerihos. Që andej shiko tokën e Kenaanit që do t'ua jap izraelitëve për pronë. Do të vdesësh në atë mal dhe do të bashkohesh me të parët e tu" ... (Besëlidhja: 32/48)

Teurati përmend se Jushua Ibn Nuni, i cili trashëgoi profetësinë pas Musait (a.s.), u urdhërua që të sulmonte muret e Tokës së Shenjtë me brezin e dytë të bijve të Izraelit: "Pas vdekjes së Mosheut, Zoti i tha Joshuas, birit të Nunit, ndihmësit të Mosheut: "Shërbëtori im, Mosheu, vdiq. Erdhi koha, kur ju duhet

të hyni në vendin që do t'ju jap. Udhëhiqe mbarë popullin e Izraelit për të kaluar lumin Jordan"... (Joshua: 1/1-2)

Pas kësaj, Teurati fillon një rrëfim të gjatë dhe të zgjeruar për Tokën e Shenjtë dhe Tempullin në periudhën e artë të bijve të Izraelit, atë të mbretërve, duke treguar së pari për tempullin që deshi të ndërtonte Davudi (a.s.), të cilin ia la amanet të birit, Sulejmanit (a.s.). Në të përshkruhen me hollësi karakteristikat e Tempullit që i shkante për shtat atij profeti-mbret.

Duhet të mos harrojmë se të gjitha këto ndjenja dhe emocione për Tokën e Shenjtë dhe Tempullin që krijon tek çifutët rrëfimi i Teuratis janë të njëjta edhe tek të krishterët. Përputhja për sa i përket shenjtërisë së tyre është një besim i patundur tek të dyja këto fe, të cilat rrjedhin nga i njëjti libër, Bibla, e cila përmbledh Teuratin dhe Ungjillin.

2. TALMUDI DHE TEMPULLI

Me termin Talmud kuptojmë përmbledhjen e komenteve mbi Teuratin, të bëra gjatë periudhave të ndryshme nga rabinët çifutë. Ky është një libër i fshehtë, i përpiluar gjatë një periudhë kohore 400-600 vjeçare dhe që përbëhet nga njëzet vëllime të trasha. Ai arriti të dominojë mendimin çifut dhe u bë një libër i shenjtë për çifutët ashtu si Teurati, bile edhe më i shenjtë se vetë ai. Është e natyrshme që Talmudi, si një përmbledhje komentesh mbi Teuratin, të trajtojë dhe komentojë rrëfimet teuratike për Tokën e Shenjtë dhe Tempullin, ndaj për rrjedhojë, në të përfshihen një mori historish për to, veçse Talmudi shquhet për stilin e tij, në të cilin mbizotërojnë ekzagjerimet dhe bestytnitë.

Në Talmud thuhet:

"Toka e Palestinës është e pastërt, prandaj duhet patjetër që të devotshmit nga bijtë e Izraelit të varrosen në të. Nëse kjo gjë nuk është e mundur, atëherë, së bashku me të vdekurin, futet në varr pak dhe` i marrë prej saj".

"...Ai që ecën katër hapa në tokën e Izraelit është e sigurt se është nga bijtë e botës tjetër".

"Kur u fut Titusi në Tempull dhe me një të rënë të shpatës së tij grisi perden e Tempullit, prej saj filloi të rrjedhë gjak. Për ta ndëshkuar atë u dërgua një mushkonjë, e cila iu fut në tru. Atje ajo filloi të zmadhohej derisa u bë sa një

pëllumb. Kur hapën kafkën e Titusit, panë se mushkonja kishte gojë bakri dhe thonj hekuri".

"Nabukodonosori e shkatërroi vendin e Izraelit, shembi Tempullin e Shenjtë dhe grabiti të gjithë gurët e çmuar, duke e lënë atë në mëshirën e zjarrit". Me poshtë vazhdon e thotë: "Që nga shkatërimi i Tempullit e deri tani, Zoti (i pastërt është Allahu nga ato që thonë) nuk ka pushuar së qari dhe vajtuari, sepse Ai bëri një gabim të rëndë. Ky gabim i rëndoi shumë në ndërgjegje Zotit, sa që Ai e kalon tre të katërtën e natës i mbyllur në vetvete duke e mbushur botën me bulurima si një luan. Ai thërret: 'I mjeri unë që e lashë shtëpinë time të plaçkitesj, tempullim tim të digjej dhe bijtë e mij të shpërndahen si zogjtë e korbit'?!!!

3. "PROTOKOLLET E TË URTËVE TË SIONIT" DHE TEMPULLI

"Protokollet e të urtëve të Sionit" është një libër me disa kapituj ose më mirë një plan-projekt për krijimin e Shtetit Botëror Çifut, i cili do të sundojë botën nga Kudsi (Jeruzalemi) nën kurorën e një mbreti nga gjaku i Davidit. Këto protokolle u përpiluan nga një grup krerësh çifutë gjatë kongresit të tyre të parë botëror të mbajtur në qytetin Bal të Zvicrës në vitin 1897, nën drejtimin e babait të sionizmit modern, Teodor Herclit (Theodor Herzl). Në këtë kongres morën pjesë mendimtarët më të mëdhenj çifutë, të cilët përfaqësonin 50 organizata çifute. Që nga ai vit dhe deri në ditët tona, ky tubim i njohur me emrin Kongresi Botëror Çifut mbahet çdo vit.

Pa dyshim, Protokollet përfaqësojnë një burim kryesor të mendimit çifut bashkëkohor. Nuk do të merrem me trajtimin në hollësi të këtyre protokolleve, të cilat janë intrigat dhe planet më kobzeza që janë bërë ndonjëherë kundër racës njerëzore, por do të tregoj vetëm pasazhet ku tregohet haptas qëllimi përfundimtar i projektuesve të tyre: ngritja e Mbretërisë Botërore Çifute nën kurorën e një mbreti nga gjaku i Davidit, i cili do të sundojë botën nga Oroshilimi (Kudsi).

Në Protokollet thuhet:

"Kur të vijë koha, që Sovrani ynë, Zot i Botës, të kurorëzohet, atëherë do të jenë po këto duar që do të qërojnë çdo gjë që do të na bëhet pengesë në rrugën tonë". (Protokolli III)

"Për botën nuk ka ndonjë ndryshim se kush është zoti i saj sovran, a është kreu i kishës katolike apo despoti ynë me gjak Sioni". (Protokolli V)

"Është thënë nga profetët që ne jemi të zgjedhur nga vetë Zoti për të sunduar mbarë botën. Zoti na ka dhuruar gjenialitetin që të mund ta kryejmë këtë detyrë. Nëse në kampin kundërshtar do të kishte ndonjë gjeni, atëherë ai do të na luftonte, por i sapoardhuri nuk mund të matet me atë që është ngulitur me kohë: lufta ndërmjet nesh do të ishte e pamëshirshme, një luftë që bota nuk e ka parë kurrë. Dhe do të ishte shumë vonë për gjenin e tyre". (Protokolli V)

"Sundimi ynë do të fillojë në çastin kur njerëzit, të coptuar nga përçarjet dhe të munduar nga dështimi i sundimtarëve të tyre, do të thërrasin: Na i hiqni ata dhe na jepni një sundimtar të vetëm botëror, që mund të na bashkojë, një sundimtar që mund të na japë paqen dhe rehatinë". (Protokolli X)

"Kur të ngrejme mbretërinë tonë, ekzistenca e çdo feje tjetër do të jetë e padëshirueshme për ne" (Protokolli XIV)

Duke u mbështetur tek Teurati dhe Talmudi, çifutët besojnë se kjo mbretëri, për të cilën flasin Protokollat, do të sundojë botën nën udhëheqjen e mbretit të shumëpritur, i cili do të qeverisë botën nga Oroshilimi (Kudsi), pasi të rindërtohet Tempulli.

4. SIONIZMI DHE TEMPULLI

Një lëvizje e fuqishme lindi nga planet çifute për ngritjen e Shtetit Botëror Çifut, të parashtruara nga Protokollat: lëvizja sioniste moderne. Kjo lëvizje nuk qëndroi larg në vëmendjen dhe interesimin e saj nga Toka e Shenjtë dhe Tempulli. Në Fjalorin Politik, jepet përcaktimi i sionizmit:

"Sionizmi është një lëvizje fetare dhe politike çifute, e cila e ka marrë emrin e saj nga mali Sion, që ndodhet në jugperëndim të Kudsit të vjetër. Ajo synon të rikthejë lavdinë e Izraelit nëpërmjet ngritjes së një shteti çifut në Palestinë. Sapo të ketë shtënë në dorë Kudsin, ajo ka ndërmend që të ngrejë në vend të Xhamisë El-Aksa Tempullin e Sulejmanit. Në krye të këtij shteti që punon për të shtrirë sundimin e tij në lindje dhe në perëndim, është mbreti i çifutëve nga gjaku i Davidit, në duart e të cilit është sundimi i botës. Sionizmi përzien politikën me fenë, duke e bërë këtë të fundit strumbullar, rreth të cilit vërtitet politika".

Mali Sion përmendet së bashku me vendet e shenjta për çifutët në shumë vende në Teurat: "Në të ardhmen mali ku qëndron Tempulli do të jetë më i larti, i ngritur lart mbi të gjitha kodrat e tjera. Shumë kombe do t'i drejtohen turma-turma, dhe popujt e tyre do të thonë: 'Të ngjitemi në malin e Zotit, në Tempullin e Perëndisë së Izraelit. Ai do të na mësojë se ç'duhet të bëjmë; do të ndjekim rrugën që do të a caktojë ai'. Sepse mësimi i Zotit do të vijë nga Jeruzalemi dhe Zoti do të flasë nga Cioni me popullin e tij". (Jeshaja 2/2-3)

Në Enciklopedinë Britanike, shpjegimi i fjalës "sionizëm" jepet kështu: "Çifutët aspirojnë për rikthimin e Izraelit, tubimin e popullit të tyre në Palestinë, ngritjen e shtetit çifut, rindërtimin e Tempullit të Solomonit (Sulejmanit) dhe vendosjen e fronit të Davidit në Jeruzalem, mbi të cilin të qëndrojë një mbret nga gjaku i Davidit".

Enciklopedia Çifute e jep në këtë mënyrë kuptimin e fjalës "sionizëm": "Çifutët duan që të bashkohen për t'u shpërngulur në Jeruzalem, duke mposhtur fuqinë e armiqve, për të rikthyer adhurimin në Tempull, në vendin e Xhamisë El-Aksa, dhe duke krijuar atje pronat e tyre".

Në Enciklopedinë Britanike thuhet: "Me emrin Sion, në fillim njihej Mali i Jëvusasve, i cili ndodhet në pjesën jugore të Jeruzalemit. Kur mbreti David pushtoi Jeruzalemin, mendoi që të ndërtojë në atë vend Shtëpinë e Zotit. Pas tij erdhi mbreti Solomon, i cili e kreu këtë detyrë. Që nga ajo kohë, me emrin Sion filloi që të quhej i gjithë rajoni dmth krejt Qyteti i Shenjtë".

Nëpërmjet këtyre pasazheve bëhet e qartë se sionizmi, ndonëse është rrymë politike, e ka marrë emrin dhe emblemën nga Tempulli dhe Toka e Shenjtë, për hir të së cilëve lufton, duke e konsideruar veten si lëvizje që synon të rikthejë lavdinë e humbur të Izraelit dhe të rindërtojë Tempullin e Sulejmanit mbi gërmadhat e Xhamisë El-Aksa, për të shtrirë më pas sundimin e saj mbi të gjithë botën nëpërmjet mbretit të çifutëve, i cili është për ta Mesia i Premtuar.

Dhe lëvizja sioniste ia doli të kishte sukses në realizimin e një pjese të madhe të synimeve të saj që përfaqësohen deri tani nga kthimi i tyre në Palestinë, ngritja e një shteti çifut në tokën e saj, pastaj pushtimi i qytetit të Kudsit dhe caktimi i tij si kryeqytet i shtetit të Izraelit. Duke punuar me ngulm për rindërtimin e kibles së çifutëve, Tempullit të Tretë të Shenjtë, ata synojnë ravijëzimin e të gjitha kontureve të shtetit fetar. Lavdia e Izraelit, për rikthimin e të cilit punon

lëvizja sioniste, nuk ndalet vetëm tek Mali apo toka përreth, por përfshin një pjesë të madhe tokash të vendeve islame. Meahem Begini shkruan në librin e tij "Revolucioni": "Që nga kohët e Teuratit, toka e Izraelit ka qenë konsideruar si toka e kombeve për bijtë e Izraelit. Më pas kjo tokë u quajt me emrin Palestinë. Gjithmonë në të kanë qenë përfshirë të dy brigjet e lumit Jordan, Libani jugor dhe jugperëndimi i Sirisë. Coptimi i atdheut është një veprim i paligjshëm, ndaj e gjithë toka e Izraelit do t'i kthehet popullit të Izraelit përjetë".

Ndërsa Ben Gurioni zbulon, duke u mburrur, shkakun që e ndalon disa herë Izraelin që të zgjerohet edhe më tej. Ky është as më pak dhe as më shumë, veçse etapëzimi kohor. Ben Gurioni thotë: "Shpatën e kemi futur në mill, por vetëm përkohësisht. Ne do ta nxjerrim përsëri nëse kërcënohet liria e atdheut tonë, vendit të profetëve të Teuratit. Atëherë i gjithë populli çifut do t'i rikthehet kolonizimit në tokën e baballarëve dhe stërgjyshërve, e cila shtrihet që nga Nili deri në Eufrat".

5. MASONIZMI DHE TEMPULLI

Sipas përkufizimit të orientalistit hollandez Dozi, masonizmi është "një grupim i madh rrymash të ndryshme, të cilat punojnë për një qëllim të vetëm: rindërtimin e Tempullit, i cili është simboli i shtetit të Izraelit". Fjala "masonizëm" rrjedh nga fjala angleze "freemason" që do të thotë "murator i lirë".

Që nga krijimi i tij, masonizmi vajton për fatin e Tempullit, duke shfaqur një interes dhe preokupim të madh për rindërtimin e tij, sepse ai është simboli i krenarisë së Izraelit dhe drita e syve të tij. Masonizmi fshihet nën emra të ndryshëm: Rotary Club (Klubi Rotari), Lions (Luanët), Bnai Brith (Bijtë e Premtimit), Ittihad ve Terakki (Lëvizja e xhonturqve në Kalifatin Islam), Dëshmitarët e Jehovahit, Baha'izmi etj, por të gjitha takohen në një pikë: rindërtimin e Tempullit.

Së pari, ato synojnë të eliminojnë të gjitha ato fe që janë në kundërshtim me fenë çifute, duke i hapur rrugën dominimit të botës nga çifutët. Pas sionizmit, masonizmi është arma e dytë zbatuese që përdorin çifutët për realizimin e planeve të tyre.

Në të gjitha përkufizimet e masonizmit të bëra nga vetë masonët, thuhet se gjoja kjo organizatë ka ekzistuar që në kohën e ndërtimit të Tempullit të Sulejmanit. Kjo gjë vihet re në të gjitha deklaratimet e kryetarëve të masonëve arabë: Xhorxhi Zejdan-it, Shahin Makarjos-it dhe Ilija El- Haxhixh-it (që të gjithë të krishterë). E gjitha kjo tregon se masonizmi është vegël e sionizmit.

Në muajin korrik të vitit 1956, në buletin zyrtar të Lozhës "Grand Orient" të Francës thuhet: " Ne masonët nuk mund të heqim dorë nga lufta që zhvillohet ndërmjet nesh dhe feve të tjera. Fitorja jonë ose fitorja e tyre është diçka e paevitueshme, po ashtu edhe vdekja jonë ose ajo e tyre. Ne nuk do të jemi kurrë të qetë pa i mbyllur të gjitha vendet e adhurimit".

Masonët nuk do të kënaqen veçse pas rihapjes së një vendi adhurimi, i cili është Tempulli i Tretë. Ata ia kanë kushtuar krejt jetën e tyre detyrës së ndërtimit të tij, duke u vetëquajtur ndërtuesit e tij të lirë. Në buletin çifut të vitit 1861 thuhet: "Thelbi i masonizmit evropian është i njëjtë me atë të jehudizmit në lidhje me besimet e tij themelore. Ai ka të njëjtën shembull dhe të njëjtën gjuhë dhe në shumicën e rasteve, të njëjtën organizim. Shpresat që ndriçojnë dhe mbështesin rrugën e masonizmit janë po ato që ndriçojnë dhe mbështesin rrugën e Izraelit. Vendkurorëzimi i tyre është Shtëpia e Mrekullueshme e Adhurimit, ku Kudi bëhet simbol dhe përmbysje fitimtare". Idris Ragibi, një nga masonët arabë, thotë: "Besimi ynë i patundur në domosdoshmërinë e ngritjes së Tempullit e forcon imanin tonë tek premtimet e përmendura në Libër".

Në Enciklopedinë Masone të botuar në Filadelfia në vitin 1906 thuhet: "Çdo llozhë masone duhet të jetë simbol i Tempullit të çifutëve dhe ato ashtu janë. Po ashtu duhet që çdo mësues llozhe (mjeshtër) mbi fronin e tij të jetë përfaqësues i mbretit të çifutëve dhe çdo mason mishërim i elementit çifut".

Në lutjen që lexohet nga të gjithë masonët e gradës së 33-të në llozhat masonike thuhet: "Do të kthehem në kohën e Solomonit, birit të Davidit dhe do të ndërtoj Tempullin më të Shenjtë. Do të lexojmë në të Talmudin dhe do të realizojmë në të çdo gjë që thuhet nëpër testamente dhe premtime. Për hir të lavdisë së Izraelit, ne nuk kursejmë asnjë mund pa bërë... Mjerë kolonistët grabitës, ne do t'i bëjmë ata kafshata për gojën e luanëve. Hakmarrje, hakmarrje! O Zot, na dhuro dritat e Jeruzalemit, të cilat iu shfaqën Moabit". Autori i librit "Masonizmi lakuriq", i cili pati qenë mason dhe më pas

hoqi dorë prej saj, thotë: "Masonët çifutë besojnë se nuk ka mbetur veçse pak kohë nga prishja e Xhamisë El-Aksa, Xhamisë së Shkëmbit dhe kishës së Ditës së Gjykimit, si dhe nga ngritja e Tempullit aty ku ndodhet El-Gamama dhe ku ngrihen dy shtyllat në të majtë dhe në të djathtë të portës".

DOKTRINA MBI MESINË E PRITUR TEK ÇIFUTËT DHE TË KRISHTERËT. LIDHJA QË EKZISTON NDËRMJET SAJ DHE RINGRITJES SË TEMPULLIT

1. BESIMI I ÇIFUTËVE TEK MESIA I TYRE I PREMTUAR

Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis besimit të çifutëve tek Mesia i Premtuar dhe orvatjeve të tyre për shkatërrimin e Xhamisë El-Aksa dhe ndërtimin në vend të saj të Tempullit të Tretë. Ky besim i tyre është i lashtë. Ëndrra e rindërtimit të Tempullit, si përgatitje e terrenit për daljen e Mesisë së tyre të Premtuar, i ka tunduar gjithmonë lëvizjet sioniste gjatë gjithë historisë. Librat e tyre të shenjtë i mësojnë ata se prej tij do të vijë shpëtimi i çifutëve dhe se ai do të kurorëzohet mbret i tyre. Sipas besimeve të tyre, ai do të sundojë botën nga Oroshilimi (Kudsi), nga Shtëpia e Zotit, nga Tempulli i Tretë.

Nga ana tjetër, shumë sekte të krishterë besojnë se ndërtimi i Tempullit do të çojë në daljen për herë të dytë të Mesisë, ndërkohë që çifutët besojnë se ai do të vijë për herë të parë. Natyrisht, për çifutët, ai nuk është Mesia, Isai, biri i Merjemes (a.s.).

Në Teurat thuhet: "...Sepse lindi për ne fëmijë, na u dha bir! Dhe ai do të jetë sundimtari ynë. Ai do të quhet Këshilltar i urtë, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, sundimtar paqeprurës. Mbretërimi i tij do të shtrihet gjithandej dhe do të zotërojë paqja e qëndrueshme. Ai do të mbretërojë si trashëgimtar i fronit të Davidit dhe sundimi i tij do të qëndrojë përgjithmonë, duke u bazuar në drejtësinë e Perëndisë. Perëndia i gjithëpushtetshëm vendosi kështu dhe do ta realizojë këtë". (Jeshaja: 9/6-9)

Mund të thuhet se ai, për të cilin flitet në këtë pasazh, është Muhammedi (savs) për dy arsye:

Së pari, sepse vula e profetësisë rëndoi mbi shpatullat e tij. Kjo është njëra nga shenjat e profetësisë së tij, e cila është paralajmëruar më parë nga të gjithë të dërguarit.

Së dyti, sepse ai u dërgua me shpatë, të cilën e ngjeshte në brez dhe e ngrinte sa herë që godiste me të.

Ndoshta në këtë pasazh bëhet fjalë për daljen e një të njeriu të shumëpritur përpara Ditës së Gjykimit, Isait (a.s.), i cili do të zbresë në kohën e fundit, siç tregohet në hadithet e shumta. Dihet se Isai (a.s.) është nga gjaku i Davudit nga ana e së ëmës, Merjemes, sepse ai nuk ka baba.

Cilido që të jetë kuptimi i këtij pasazhi, profetësia e Muhammedit (a.s.) apo zbritja e Isait (a.s.) në kohën e fundit, çifutët në të nuk kanë asnjë pjesë, sepse ata i mohuan që të dy ata dhe i luftuan, duke preferuar që të pritnin edhe më.

Ashtu si në Teurat, edhe në Talmud flitet për Mesinë e Pritur që do të sundojë botën nga vendndodhja e Tempullit të Tretë. Ja çfarë thuhet në të: "Dhe do të vijë Mesia i vërtetë dhe do të ndodhë fitorja e pritur. Atëbotë, Mesia do të pranojë dhurata nga çdo popull, duke refuzuar dhuratat e të krishterëve. Kombi çifut në atë kohë do të jetë në majat e pasurisë, sepse do të marrë të gjitha pasuritë e botës".

"Kur të vijë Mesia, toka do të nxjerrë ushqime, veshje leshi dhe grurë, kokrrat e të cilit do të jenë sa veshkat e demave. Në atë kohë, pushteti do t'u kthehet çifutëve dhe të gjitha kombet do t'i shërbejnë këtij Mesie. Çdo çifut do të ketë në zotërimin e tij dymijëetreqind skllëvër që do të jenë në shërbim të tij. Mesia nuk do të vijë veçse pas zhdukjes së sundimit të kombeve që janë jashtë fesë së bijve të Izraelit".

Pas studimit që i bëri Talmudit, Dr. Xhozef Barkli thotë: "Në të (Talmud), çështja e Mesias është çështja më e rëndësishme e çifutëve." Talmudi flet për luftën që do të ndizet afër ardhjes së Mesisë: "Përpara se çifutët të sundojnë përfundimisht, duhet të zhvillohet një luftë e ashpër dhe të zhduken dy të tretat e botës. Atëherë do të vijë Mesia i vërtetë dhe do të realizojë fitoren e afërt".

Të ndikuar nga ky besim i tyre në Mesinë e Pritur dhe të nisur mbi bazën e tij, nga gjiri i çifutëve dolën njëri pas tjetrit shumë pretendentë dhe sharlatanë, çdonjëri nga të cilët pretendonte se ishte Mesia i Premtuar. Kështu ndodhi në vitet 640, 720, 750, 1660 dhe 1648 të erës sonë. Në fundin e shekullit të shkuar, çifutët filluan të thurin plane kobzeza, realizimi i të cilave do të përgatiste terrenin për vendosjen e të gjithë botës nën sundimin e tyre. Për këtë qëllim, ata iu përveshën punës për nxitjen e përçarjeve dhe zbatimin e kompleteve të njohura me emrin "Protokollet e të urtëve të Sionit".

Protokollet nuk janë veçse një program i detajuar për nxitjen e korrupsionit dhe degjenerimit në tokë, i cili synon ta përgatisë botën për ardhjen e Mesisë së Pritur dhe lehtësimin e rrugës së tij drejt fronit të një qeverije të vetme botërore, e cila do të sundojë botën nga Oroshilimi, Kudsi.

Le të lexojmë këto pasazhe nga Protokollet e Sionit: "Qeveria jonë do të paraqitet si një mbrojtëse atërore e personifikuar në personin e sundimtarit tonë. Kombi ynë dhe nënshtetasit tanë do të shikojnë tek ai një baba që kujdeset për çdo nevojë të tyre, për çdo veprim të tyre dhe për marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin si dhe ato me sunduesin. Për pasojë, ata do të indoktrinohen aq shumë me mendimin se është e pamundur të bëjnë pa mbrojtjen dhe udhëheqjen e tij, në se duan të jetojnë në paqë dhe qetësi, sa që ata do ta pranojnë autokracinë e sunduesit tonë me devocion..." (Protokolli XV)

"Kur Mbreti i Izraelit të vendosë në kokën e tij të shenjtë kurorën që do t'ia ofrojë Europa, ai do të bëhet patriarku i gjithë botës". (Protokolli XV)

"Sunduesi ynë gjithmonë në mes të popullit do të rrethohet nga një turmë, të cilët do të duken si burra dhe gra kureshtarë, që do të zënë rradhët e para përreth tij..." (Protokolli XVIII)

"Ky i Zgjedhur i Zotit është i zgjedhur nga lart për të shkatërruar forcat e pavetëdijshme të udhëhequra nga instikti dhe jo arsyeja, nga brutaliteti dhe jo nga humanizmi. Këto forca tani triumfojnë të mishëruara në formën e grabitjes dhe të çdo lloj dhune tjetër, nën maskën e parimeve të lirisë dhe të drejtave. Ato kanë shkatërruar të gjitha sistemet shoqërore, për të ngritur mbi gërmadhat e tyre fronin e Mbretit të Çifutëve, por roli i tyre do të mbarojë në çastin kur ai të hyjë në mbretërinë e tij. Atëherë do të jetë e nevojshme t'i qërojmë ato nga rruga e tij, në të cilën nuk duhet lënë asnjë pengesë.

Atëherë do të mund t'i themi popujve të botës: - Falenderoni Zotin dhe përuluni përpara Tij, në ballin e të cilit qëndron vula e paracaktimit të njeriut, të cilit vetë Zoti ia ka udhëhequr yllin. Askush tjetër, përveç Tij, nuk mund të na çlirojë nga të gjitha forcat dhe të këqijat e sipërpërmendura". (Protokolli XXIII)

Në Protokollin XXIV, i cili është edhe protokoll i fundit, ligjëruesi thotë: "Tani do të trajtoj mënyrën se si do të forcohet shteti i mbretit David, në mënyrë që të vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit". Protokollet mbyllen me këtë shprehje:

"Shtylla e njerëzimit, e mishëruar në sunduesin suprem të të gjitha botërave që rrjedh nga fara e shenjtë e Davidit, duhet t'i sakrifikojë të gjitha dëshirat e tij personale për hir të popullit të tij.

Mbreti ynë duhet të jetë shembulli i plotfuqishmërisë".

2. BESIMI I TË KRISHTERËVE TEK MESIA I PRITUR

Të nisur mbi bazën e besimeve që rrjedhin nga Dhjata e Vjetër dhe ajo e Re, shumë sekte të krishtera e shenjtërojnë Tempullin. Sipas pikëpamjes së tyre, feja e krishterë është një zgjerim dhe vazhdim i mëtejshëm i fesë çifute, ndaj çdo gjë e shenjtë për ithtarët e Dhjatës së Vjetër është po ashtu e shenjtë edhe për ata të Dhjatës së Re. Këto sekte të krishtera besojnë se rindërtimi i Tempullit do të përshpejtojë ardhjen për të dytën herë të Mesisë së tyre, Isait, të birit të Merjemes (a.s.). Për këtë qëllim, ata bashkëpunojnë me çifutët për të arritur objektivin e tyre: shembjen e Xhamisë El-Aksa dhe Xhamisë së Shkëmbit, rindërtimin e Tempullit dhe pritjen e ardhjes së afërt të Mesisë, i cili kësaj here, sipas tyre do t'i fusë çifutët në fenë e tij. Dallimet që kanë në lidhje me personin e Mesisë nuk e kanë penguar punën e përbashkët për realizimin e qëllimit të njëjtë. Të dyja palët bien dakord për domosdoshmërinë e rindërtimit të Tempullit në sheshin e Xhamisë El-Aksa. Një nga të parët e çifutëve i tha kolegëve të tij të krishterë: "Ju pritni ardhjen e Mesisë për herë të dytë, ndërsa ne presin ardhjen e tij për herë të parë, prandaj le të fillojmë së pari me ndërtimin e Tempullit. Pas ardhjes së Mesisë, t'i përvishemi punës së bashku për zgjidhjen e problemeve të tjera që na kanë mbetur".

Në Asamblenë e Dytë Botërore të Kishave të Krishtera të mbajtur në Evanston në vitin 1954, komiteti i posaçëm i kërkimeve çifuto-kristiane nxorri një raport në të cilin thuhet: "Shpresa e krishterë për ardhjen e dytë të Mesisë nuk mund të kuptohet e ndarë nga shpresa e popullit të Izraelit, të cilën e shohim qartë jo vetëm në librat e Dhjatës së Vjetër, por edhe në ndihmën e përhershme hyjnore për këtë popull, ndaj nuk do të jemi të qetë derisa populli i zgjedhur i Zotit ta pranojë Mesinë për mbret".

Sipas mësimeve ungjillore, përpara ardhjes së dytë të Mesisë duhet të plotësohen tre gjëra:

1. Izraeli duhet të bëhet shtet
2. Jeruzalemi duhet të jetë kryeqyteti i këtij shteti
3. Duhet të rindërtohet Tempulli.

Shkrimtarja amerikane Grejs Halsel ka shkruar një libër të titulluar: "Qëllimi vrasës: Misionarët protestantë në rrugën drejt luftës bërthamore", në të cilin publikohen informacione tronditëse rreth bashkëpunimit të të krishterëve me çifutët për realizimin e një të vetmit qëllim. Zonja Halsel thotë:

"Komentimi që i bëjnë Teuratit sektet protestante në SHBA është shndërruar në një burim kryesor nga i cili dhjetëra miliona njerëz marrin sistemin e besimeve të tyre. Këta misionarë zotërojnë shumë stacione radios dhe televizioni në Shtetet e Bashkuara, ndërsa disa prej tyre janë të pranishëm në institucionet qeveritare dhe Kongresin amerikan, bile vendosin edhe kandidaturën për president të SHBA-së. Të gjithë ata besojnë në afrimin e fundit të botës si një gjë nga e cila nuk ka shpëtim, e cila përkundrazi duhet përshpejtuar, jo për gjë tjetër, veçse për realizimin e profecive. Për këtë qëllim, ata inkurajojnë armatosjen bërthamore, duke mos e çarë kokën për deficitin e buxhetit amerikan që rritet nga dita në ditë. Kjo gjë do të afrojë ardhjen e Ditës së Armagedonit (ose Harmagedonit) dhe si rrjedhim, rikthimin e Mesisë. Sipas këndvështrimit të tyre, botës i ka ardhur fundi dhe po afrohet beteja përcaktuese përfundimtare, e cila do të shpërthejë në Lindjen e Mesme, bile më saktësisht në Megido të Palestinës. Këta misionarë kanë një numër organizatash, të cilat janë të gjitha në shërbim të qëllimeve të lëvizjes sioniste. Disa nga këto organizata janë specializuar në mbledhjen e parave për zhdukjen nga faqja e dheut të Xhamisë El-Aksa dhe ndërtimin në vend të saj të Tempullit çifut".

Misionari amerikan Ouen thotë:

"Ne besojmë se hapi tjetër pas ngritjes së shtetit të Izraelit dhe kthimit të çifutëve në Jeruzalem, do të jetë rindërtimi i Tempullit, gjë e cila do të çojë në kthimin e Mesisë. Çifutët, me ndihmën e të krishterëve, duhet të shkatërrojnë

faltoren ekzistuese (Xhaminë El-Aksa) dhe të ndërtojnë Tempullin, sepse këtë e thotë Ungjilli".

Gjithashtu ky misionar thotë:

"Terroristë çifutë do të hedhin në erë vendin e shenjtë të muslimanëve, duke provokuar botën islame që të futet në një luftë të shenjtë dhe shkatërrimtare me Izraelin, e cila do ta shtrëngojë Mesinë e Pritur që të ndërhyjë. Çifutët besojnë se ardhja e tij do të jetë e para, ndërsa ne e dimë mirë se ajo do të jetë vizita e tij e dytë. Po! Duhet që patjetër të ngrihet një tempull i tretë".

BESIMI NË DITËN E MEGIDOS OSE HARMAGEDONIT

Nga besimet e përbashkëta që hasen tek të krishterët dhe çifutët është edhe besimi në ardhjen e ditës në të cilin do të ndodhë një betejë ndërmjet forcave të mirës dhe së keqes. Kjo betejë do të jetë më e madhja në historinë e njerëzimit dhe do të ndodhë, sipas besimit të tyre, në rajonin e Megidos në Palestinë. Ky vend ndodhet 55 milje larg Tel Avivit, 20 milje në lindje të qytetit të Hajfas dhe 15 milje larg brigjeve të Detit Mesdhe. Me këtë vend lidhet besimi i lashtë se çdo komandant që e pushton atë është në gjendje t'i bëjë ballë çdo sulmi. Çifutët dhe të krishterët që i ndjekin pas besojnë se një ushtri e përbërë nga 200 milionë ushtarë do të vijë në Megido për luftën përfundimtare. Në vitin 1984, fondacioni "Jankloviç" kreu një sondazh, nga i cili rezultoi se 39% e popullit amerikan, pra rreth 85 milionë amerikanë, besojnë se tregimi i Biblës mbi shkatërrimin e tokës me zjarr përpara Ditës së Gjykimit do të bëhet në një luftë përcaktuese bërthamore, e cila do të ndodhë patjetër.

Ndërsa për sa i përket lidhjes së këtij besimi me çështjen e Tokës së Shenjtë, ndërtimit të Tempullit dhe ardhjen e Mesisë, të krishterët evangjelistë besojnë se nuk do të ketë asnjëherë paqe të vërtetë, as në Lindjen e Mesme dhe as në botë, derisa të vijë Mesia i Premtuar që do të ulet në fronin e Davidit dhe do të luftojë armiqtë e Izraelit. Krerët e tyre besojnë se në Ungjill gjendet një profeci, e cila tregon se kthimi i Mesisë do të ndodhë pas një periudhe luftërash dhe katastrofash natyrore, të cilat, së bashku me rindërtimin e Tempullit, do të ndodhin përpara këtij kthimi të dytë. Ky besim kristiano-çifut e ka origjinën në Teurat, në të cilin thuhet: "Perëndia, Zoti, thotë: Atë ditë kur Gogu të sulmojë Izraelin, zemërimi im do të ndizet. Që tani jam i mbushur me inat dhe betohem: Atë ditë në këtë vend do të bjerë një tërmet i madh. Njerëzit dhe kafshët do të dridhen para meje, madje edhe zogjtë në ajër dhe peshqit në det. Malet do të çahen, shkëmbinjtë do të bien mbi lugina dhe të gjitha muret do të shemben. Do të bëj që në malet e Izraelit njerëzit të nxjerrin shpatat kundër njëri-tjetrit. Do të bëj që ndër trupat e Gogut të bëhet një masakër; do të dërgoj ndër ta murtajë, do të luftoj kundër tyre me breshër dhe më shi të madh si në kohën e përmytjes së madhe, dhe do të bëj që mbi ta të bien zjarri dhe sqfuri". (Ezekieli 38/18-22)

Edhe në Talmud flitet për betejën e Harmagedonit. Aty thuhet: "Përpara se çifutët të sundojnë përfundimisht duhet që të ndodhë patjetër një luftë ndërmjet kombeve, gjatë së cilës do të shfarosen dy të tretat e botës. Pas saj, për shtatë vjet me rradhë, çifutët do të djegin armët që zunë pas fitores. Atëherë nga gojët e armiqve të bijve të Izraelit do të mbijnë dhëmbë që do të jenë njëzet e dy bërryla të gjatë!!!?"

Deri Protokollat e Sionit flasin për atë betejë: "Është thënë nga profetët që ne jemi të zgjedhur nga vetë Zoti për të sunduar mbarë botën. Zoti na ka dhuruar gjenialitetin që të mund ta kryejmë këtë detyrë. Nëse në kampin kundërshtar do të kishte ndonjë gjeni, atëherë ai do të na luftonte, por i sapoardhuri nuk mund të matet me atë që është ngulitur me kohë: lufta ndërmjet nesh do të ishte e pamëshirshme, një luftë që bota nuk e ka parë kurrë. Dhe do të ishte shumë vonë për gjenin e tyre". (Protokolli V)

Çifutët dhe të krishterët e komentojnë këtë besim të tyrin duke e zbatuar atë tek ngjarje reale të përcaktuara. Ata besojnë se vendet e kampit lindor (në të cilin përfshijnë edhe muslimanët) janë forcat e së keqes, të cilat një ditë do të hidhen në luftë kundër forcave të së mirës të përfaqësuar nga Izraeli dhe shtetet e botës së krishterë që e përkrahin atë. Është për t'u habitur se tregimi për Harmagedonin qarkullon deri në nivelet më të larta të politikës dhe fesë në SHBA dhe Perëndim. Në një program televiziv të transmetuar më 22 shtator 1985, prifti Xhimi Suogart tha: "Duhet që të mos arrijmë në asnjë marrëveshje me Bashkimin Sovjetik. Beteja e Megidos është e afërt; ajo do të ndodhë në rrafshinën e Megidos... Ajo po vjen. Ata mund të nënshkruajnë çdo marrëveshje paqeje që të duan, por asnjëra prej tyre nuk do t'u sjellë dobi".

Prifti Xherri Faluell në një fjalim të mbajtur më 2 dhjetor 1964 tha: "Fjala Megido fut frikën në zemrat e njerëzve. Pa tjetër që do të ndodhë një përleshje e fundit, me të cilin Krijuesi do të shkatërrojë gjithësinë... Unë e di dhe ju e dini se nuk do të ketë asnjëherë paqe të vërtetë në Lindjen e Mesme, derisa Mesia të mos ulet një ditë prej ditësh në fronin e Davidit në Jeruzalem".

Bile edhe presidenti Ronald Regan kishte një besim të fortë e të patundur në afrimin e ditës së Megidos siç thonë personat e afërt me të. Në shumë deklarata të tij vihet re kjo gjë. Në një bisedë me Xhejms Millzin, kryetarin e senatit të shtetit të Kalifornisë, të botuar në gushtin e vitit 1985 në revistën "San Diego Magazine", ai ka thënë: "Kam gjetur në Bibël, se Zoti do t'i bashkojë

bijtë e Izraelit në Tokën e Premtuar dhe kjo gjë ndodhi me të vërtetë pas gati një mijë vjetësh. Për herë të parë në histori, terreni është përgatitur për betejën e Megidos dhe ardhjen e dytë të Mesisë".

SHOQATAT, ORGANIZATAT DHE PERSONALITETET ÇIFUTE DHE TË KRISHTERA QË KANË GISHT NË KOMPLOTTIN KUNDËR XHAMISË EL-AKSA

Pas sqaruam motivet që i shtyjnë çifutët dhe, së bashku me ta, disa sekte të krishtera, që të përpiqen për rindërtimin e Tempullit mbi gërmadhat e Xhamisë El-Aksa dhe asaj të Shkëmbit, do të përmendim tani fakte që tregojnë se për arritjen e objektivit të tyre, të dyja palët punojnë me ngulm dhe seriozitet që prej kohësh. Do të përmend disa aktivitete të kryera nga shoqata, organizata dhe personalitete të krishtera dhe çifute, të cilat bashkëpunojnë për realizimin e komplotit të kohës sonë.

AKTIVITETI KISHTAR

Organizatata çifute në SHBA vunë në qendër të objektivit të tyre kishën, për shkak të rolit të saj të madh në gjenerimin e ndjenjave dhe opinioneve në favor të Izraelit. Kisha ushtron një influencë të madhe nëpërmjet programeve të studimit dhe gjithçkaje që transmetohet përmes radios, televizionit, emisioneve të lajmeve, gazetave dhe periodikëve të shumtë të cilat mbërrijnë tek miliona njerëz. Gjithashtu, ajo drejton qindra universitete, gazeta dhe konferenca, si dhe një numër të madh shkollash fillore dhe të mesme. Pavarësisht nga laicizmi i dukshëm në jetën perëndimore, kisha vazhdon të mbetet një burim i rëndësishëm ndikimi në moralin, kulturën dhe besimet e atyre shoqërive. Në vitet e fundit, kisha arriti që të kishte sukses në krijimin e një rryme njerëzish të dhënë pas fesë dhe të dëshiruar për të mbushur boshllëkun me ushqim shpirtëror dhe shembëlltyra. Të njëjtën gjë që mund të themi për aktivitetin kishtar në SHBA, mund ta themi edhe për atë në Britani, e cila ashtu si dhe Amerika, i përket protestantizmit, sekt që e konsideron Teuratin si bazë, ndërsa Ungjillin si degë. Një përkrahje jo më të vogël për Izraelin e gjejmë edhe tek ithtarët e Kishës Katolike Romane, veçanërisht pas pajtimit historik që ndodhi me takimin e Papës Gjon Pali II me Shimon Peresin, kryetarin e partisë laburiste izraelite, dhe zbulimit të Papës se çifutët nuk kishin gisht në vrasjen e Mesisë!!!

EVANGJELISTËT OSE SIONISTËT E KRISHTERË

Këta janë ithtarët e kishës anglikane apo evangjeliste (ungjillore), për të cilët Xhorxh Galop Polster, në librin e tij të titulluar "Feja në Amerikë" thotë se "janë bërë rishtaz të krishterë, besojnë tek Mesia si shpëtimtar, tek tekstet e shenjta si burim i çdo besimi dhe e ndiejnë si detyrë urgjente përhapjen e fesë". Massmediat i quajnë ata fundamentalistë të krishterë. Ata përfaqësojnë një rrymë të re dhe të fuqishme në Amerikë, e cila është shprehje e të ashtuquajturit "rizgjim i krishterë".

Këta evangjelistë, të cilët përfaqësojnë grupin e krishterë më të fuqishëm në Amerikë, besojnë se ndërtimi i Tempullit do të afrojë ditën e Megidos dhe për pasojë, ardhjen e Mesisë, siç thuhet në profecitë e Biblës. Për këtë arsye, ata mbështesin orientimin çifut që synon shkatërrimin e Xhamisë El-Aksa, ndonëse janë të bindur se kjo gjë do të çojë në shpërthimin e Luftës së Tretë Botërore. Sipas vlerësimeve të shkrimtares amerikane Grejs Halsel, numri i ithtarëve të kishës evangjeliste arrin në 85 milionë dhe aktivitetet e tyre zhvillohen në shkallë të gjërë. Librat e tyre përbëjnë një të tretën e të gjithë librave të blera në Amerikë. Evangjelistët zotërojnë dhe drejtojnë 1300 stacione radioje dmth një në çdo shtatë radio në SHBA. Shkollat e tyre tërheqin numrin më të madh të nxënësve të shkollave private. Kisha evangjeliste organizon udhëtimi periodike turistike dhe fetare në Kuds për të vizituar vendet e shenjta çifute dhe të krishtera. Ekzistojnë rreth 250 organizata që mbështesin idetë e evangjelistëve, të cilat, përveç ndihmës gjithnjë e në rritje për çifutët, kanë filluar një luftë të hapur kundër muslimanëve në SHBA. Disa prej këtyre organizatave kanë ngritur degë të tyre në Palestinën e pushtuar për të marrë pjesë drejtpërsëdrejti në projektin e ndërtimit të Tempullit të Tretë.

Ndër personalitetet më të shquara që luajnë rol të spikatur në aktivitetin e kishës evangjeliste dhe që përfaqësojnë koalicionin e fortë të formuar nga kryqi dhe ylli i Davidit, mund të përmendim:

1. Arkipeshkopin Xhim Dë Losh, i cili është një përkrahës i hapur i Izraelit dhe i cili thotë: "Ungjilli është libër çifut". Ky prift mban gjithmonë në gisht një unazë me diamante, mbi të cilën janë gdhendur kryqi dhe ylli gjashtëcepësh i Davidit, ndërsa mbi jakën e kostumit mban një flamur të dyfishtë amerikano-izraelit. Ai thotë për veten e tij "Unë jam sionist i krishterë, unë jam me Izraelin

dhe Amerikën". Ky arkipeshkop është anëtar i shquar i organizatës çifute të Tempullit të Shenjtë.

2. Priftin Xhimi Suogart, njërin nga figurat më të spikatura të evangjelistëve, të njohur për aftësitë e tij të mëdha oratorike dhe zotësinë e tij për të ndikuar tek njerëzit. Gjatë ligjëratave të tij, ky prift qan, eksitohet, ngre lart Ungjillin, godet tokën me këmbë dhe i bën njerëzit që e dëgjojnë të qajnë. Jo më kot atë e cilësojnë si mbretin e misionarëve të televizionit. Suogarti arriti të ngrrejë një "perandori televizive", numri i teleshikuesve të së cilës në botë arrin në dhjetëra milionë. Gjatë një viti, ai arrin të grumbullojë rreth 150 milionë dollarë ndihma për veprimtaritë e tij. Publiku islam e njeh Xhimi Suogartin nga debati i famshëm me dijetarin e madh islam Ahmed Didatin. Nga thëniet e këtij prifti mund të përmendim: "Beteja e Megidos është e afërt; ajo do të ndodhë në rrafshinën e Megidos... Ajo po vjen. Ata mund të nënshkruajnë çdo marrëveshje paqeje që të duan, por asnjëra prej tyre nuk do t'u sjellë dobi. Problemet e Afrikës nuk do të zgjidhen... Problemet e Amerikës Qëndrore nuk do të zgjidhen... Problemet e Evropës nuk do të zgjidhen dhe problemet e Lindjes së Mesme nuk do të zgjidhen, bile do të rëndohen dhe më".

Me këto fjalë ai do të tregojë se konflikti i ardhshëm fetar në Lindjen e Mesme do të ndodhë në rajonin e Megidos në Palestinë, ndaj duhet të ndërtohet Tempulli në mënyrë që të përgatitet terreni për ardhjen e Mesisë.

3. Fizikanin Lagert Dolfin, i cili drejton një sektor të rëndësishëm të njërit nga institutet më të mëdha të kërkimeve në botë, Institutit të Kërkimeve Stanford, buxheti vjetor i të cilit arrin në 200 milionë dollarë. Ky fizikan ka shpikur një aparat fotografimi më rreze X që bazohet në tërheqjen magnetike, me anë të të cilit zbulohen sendet që ndodhen nën tokë. Dolfin i ka vënë të gjitha dhuntitë e tij në shërbim të çifutëve. Së bashku me çifutin Stenli Goldfut, kryen një fluturim mbi Xhaminë El-Aksa dhe atë të Shkëmbit duke e fotografuar atë nga ajri për të vërtetuar se Xhamia është ngritur mbi vendin e Tempullit të Sulejmanit.

ORGANIZATAT E KRISHTERA QË KANË GISHT NË KOMPLOTTIN KUNDËR XHAMISË EL-AKSA

1. AMBASADA BOTËRORE E KRISHTERË NË JERUZALEM

Evangelistët e ngritën këtë ambasadë në shtator të vitit 1980 duke synuar që selia e saj në Jeruzalem të shprehte një kuptim të qartë. Menjëherë pas ngritjes së saj, ajo lëshoi një deklaratë që fillonte me këto fjalë: "Lutja juaj duhet të drejtohet kundër shpirtit islam... Shpirti i keq i Islamit është përgjegjës për skllavërinë shpirtërore në botën arabe, për shumë veprime antisemite në mbarë botën, për armiqësinë e madhe kundër Izraelit që vihet re në shtetet e Lindjes së Mesme dhe shtetet e tjera të botës me shumicë muslimane si dhe për embargon e naftës kundër atyre shteteve që mbështesin Izraelin. Islami është fajtor për talljen e madhe që po na bën Zoti, kur në vendin më të shenjtë të malit Moriah, ngrihet një xhami muslimane. Kjo është një njollë turpi për vendin e shenjtë të Tempullit".

Kjo ambasadë e krishterë ka 15 konsullata në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme në përkrahje të Izraelit. Duke folur për to në një numër të saj të vitit 1980, gazeta çifute "Dhë Xheruzalem Post" (The Jerusalem Post) shprehet se këto veprimtari përfshijnë "nxitjen e çdo lloj propagande në favor të çështjes çifute nëpër gazeta, radio, kinematografi, debate, tubime dhe ... në netët e dashurisë për Izraelin".

2. SHOQATA E SHUMICËS MORALE

E themeluar në vitin 1979 nga prifti Xherri Faluell, kjo organizatë ka një orientim të spikatur politiko-fetar. Ajo zotëron një program të përditshëm radioteleviziv që zgjat një orë të plotë të titulluar "Ora e Ungjillit", e cila transmetohet nga 700 stacione në të gjithë botën. Gjithashtu ajo zotëron një revistë periodike më titull "Zëri i krishtërit". Nëpërmjet organizatës së tij, Faluelli organizon udhëtime në Tokën e Shenjtë, gjatë të cilave kryhen vizita në luginën e Megidos dhe vende të tjera teuratike. Sipas një sondazhi zyrtar të kryer nga instituti "Konservativ Dajxhest" (Conservative Digest), Faluelli gëzon një popullaritet dhe admirim të madh jashtë Kongresit; pas tij vjen presidenti Ronald Regan. Ai është mik personal i Beginit dhe Shamirit. Faluell ka thënë: "Këtë komb të vogël (dmth Izraelin) do ta sulmojnë përsëri armiqtë e tij të prirë nga ushtritë ruse dhe aleatët e tyre arabë, por siç ka profetizuar Ezekieli, rusët do të munden dhe dora e Zotit do ta shpëtojë edhe një herë Izraelin".

3. SHOQATA FETARE "TRYEZA E RRUMBULLAKËT"

E themeluar në vitin 1979 për të koordinuar programin e punës së të djathtës së krishterë, kjo shoqatë përfshin në gjirin e saj një numër të madh organizatash nga më të mëdhatë. Nga veprimtaret më të suksesshme të së djathtës së krishterë përmendim organizatat "Përkthyesit e Librit të Shenjtë" dhe "Lidhja e Kishave në Amerikë", të cilat janë organizma kërkimesh që punojnë në fshehtësi të plotë dhe që kanë hapur dosje për mijëra personalitete të botës. Mbështetjen për Izraelin kjo organizatë e justifikon me shkaqe teologjike strategjike.

4. FONDACIONI "MALI I TEMPULLIT"

Kjo organizatë është themeluar nga Terri Rezenhofer dhe punon për realizimin e profecisë teuratike së ngritjes së Tempullit. Në një artikull të saj të botuar në vitin 1983, gazeta izraelite "Davar" shkruan se fondacioni amerikan i krishterë "Mali i Tempullit" tuboi 10 milionë dollarë për t'i përdorur si ndihmë për ngritjen e kolonive të reja çifute në Tokat e Pushtuara Arabe, blerjen e tokave nga vakëfet islame dhe si kontribut për realizimin e projektit të rindërtimit të Tempullit të Sulejmanit. Në vitin 1983, Rezenhoferi organizoi një fushatë protestash kundër arrestimit të kolonistëve çifutë të implikuar në një komplot kundër Xhamisë El-Aksa dhe mbuloi financiarisht të gjitha shpenzimet e mbrojtjes së tyre. Nga pasuria e tij e madhe (ai merret me shitje tokash dhe nafte), Rezenhoferi i ka dhuruar shuma të mëdha organizatës çifute "Tempulli i Shenjtë". I pyetur një ditë se a përbënte Xhamia El-Aksa një pengesë në rrugën për rindërtimin e Tempullit, ai u përgjigj: "El-Aksa-ja nuk është aspak e rëndësishme".

ORGANIZATAT DHE GRUPET ÇIFUTE TË INTERESUARA PËR PRISHJEN E XHAMISË EL-AKSA DHE NDËRTIMIN E TEMPULLIT

1. GRUPIMI GOSH EMONIM

Gosh Emonim do të thotë "Fronti i besimit", por anëtarët e tij e thërrasin grupimin e tyre me emrin "Lëvizja sioniste e përtëritjes". Themeluesi i tij është Moshe Levinger. Ky grupim punon për kolonizimin e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës, si dhe për ngritjen e Tempullit mbi gërmadhat e Xhamisë El-Aksa. Anëtarët e tij besojnë tek dhuna si i vetmi mjet për realizimin e këtij qëllimi. Ky grupim gëzon mbështetjen e qeverisë, të cilën e ka fituar me forcë.

Deni Rubinshtajn, autori i librit "Gosh Emonim-fytyra e vërtetë e sionizmit" thotë: "Nuk besojmë se lëvizja Gosh Emonim do të mund të formohej dhe punonte sipas mënyrës së saj pa një bashkëpunim të hapur dhe të fshehtë me qeveritë izraelite, veçanërisht ato të kryesuara nga Likudi. Ajo nuk është veçse një vegël e bindur e politikës së Beginit dhe Sharonit në Tokat e Pushtuara".

2. ORGANIZATA "JESHIFAT ETRIT KOHANEN" (KURORA PRIFTËRORE)

Rrënjët e saj kjo organizatë i ka tek rabini Abraham Jichak Kol, rabini i parë palestinez. Pasuesit e saj besojnë se janë pararoja e lëvizjes, e cila do të fillojë marshimin drejt Tempullit. Deri para pak kohësh, ata nuk shkonin në Malin e Tempullit për t'u lutur, sepse nuk kishte dalë akoma një fetva nga rabinët që t'u lejohej të luteshin atje. Kjo fetva doli në vitin 1985. Organizata ka të gatshme shumë projekte inxhinjerie për ndërtimin e Tempullit dhe organizon simpoziume periodike mbi Tempullin dhe mënyrat e punës për rindërtimin e tij.

3. LËVIZJA PËR PUSHTIMIN E XHAMISË EL-AKSA

Anëtarët e kësaj lëvizjeje bëjnë thirrje haptas për shembjen e Xhamisë El-Aksa dhe dëbimin e të gjithë banorëve muslimanë nga "toka e Izraelit". Ndër qëllimet parësore të kësaj lëvizjeje është çifutizimi i qytetit të Halilit (Hebronit) dhe shtënia në dorë njëherë e përgjithmonë e Xhamisë së Ibrahimit (a.s.), e cila gjendet në atë qytet, për ta shndërruar në një sinagogë çifute. Ata ia dolën të krijojnë një shumicë çifute në qytet dhe ngritën një sinagogë në dy të tretat e Xhamisë së Ibrahimit (a.s.), të cilën e quajtën sinagoga Makfir. Ndër figurat më të spikatura të kësaj lëvizjeje mund të përmendin Jizrael Arielin dhe rabinin Koren. Ky i fundit konsiderohet si udhëheqësi shpirtëror i shumë prej të rinjve çifutë që morën pjesë në sulmin kundër Xhamisë El-Aksa në vitin 1968.

4. ORGANIZATA SEJUDOS SHESHON

Kjo organizatë hiqet si një shoqatë bamirëse dhe ka mbështetjen e pakufishme të ministrisë çifute të informacionit, bashkisë së Jeruzalemit dhe ushtrisë izraelite. Ajo synon rritjen e ndërgjegjësimit për Tempullin dhe Jeruzalemin tek populli çifut në përgjithësi dhe ushtria në veçanti. Për këtë qëllim ajo organizon udhëtime periodike drejt vendeve të shenjta çifute, duke synuar që lutjet çifute të mos kufizohen vetëm tek Muri i Pikëllimit, por edhe në vende të tjera të shenjta çifute.

5. GRUPIMI EL HAR HASHEM

Emri i këtij grupimi do të thotë "Drejt malit të Zotit". Grupimi punon për rindërtimin e Tempullit dhe kryesohet nga avokati Gershon Solomon. Më 14 gusht 1987, një grup anëtarësh të tij u përpoqën që t'i kryenin me forcë lutjet çifute në Xhaminë El-Aksa.

6. PARTIA HIT-HIJA (RIZGJIMI SIONIST)

Ndonëse paraqitet sikur ndjek një vijë politike laike, kjo parti është shumë e interesuar për pushtimin e Xhamisë El-Aksa, sepse sipas pikëpamjes së tyre, kjo gjë i siguron Izraelit sovranitetin dhe fuqinë. Ajo ka disa anëtarë në Knesetin çifut. Kryetari i saj, Joval Niman, i deklaroi gazetës çifute "Maaref": "E pranoj pa pasur turp se unë e shoh Libanin si pjesë të tokës së Izraelit, Tokës së Premtuar".

7. GRUPIMI "KUJDESTARËT E TEMPULLIT"

Ky grupim merret me organizimin e lutjeve çifute në sheshin përpara Murit të Burakut (Murit të Pikëllimit). Ndër figurat më të spikatura të tij është Stenli Goldfut me origjinë nga Afrika e Jugut, i cili ka punuar më parë në shërbimet e fshehta të organizatës terroriste çifute "Shtirin", përgjegjëse për vrasjen në vitin 1948 të ndërmjetësit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, kontit Bernadot.

8. FONDACIONI "TEMPULLI I SHENJTË"

Në bordin administrativ të këtij fondacioni bëjnë pjesë edhe pesë të krishterë evangjelistë, ndër të cilët përmendim fizikanin amerikan Lagert Dolfin. Ky fondacion u themelua nga Stenli Goldfut, pas shkëputjes së tij nga organizata "Kujdestarët e Tempullit". Goldfuti së bashku me Dolfinin kryen një fluturim mbi Xhaminë El-Aksa dhe Kubenë e Shkëmbit për të bërë disa fotografime me rreze X të nëntokës me anë të një aparati të shpikur nga Dolfini. Qëllimi i tyre ishte të vërtetonin përpara botës se Xhamia El-Aksa ishte ndërtuar mbi vendin e Tempullit.

9. ORGANIZATA BETAR

Kjo organizatë synon të kryejë më forcë lutjet çifute në sheshin e Xhamisë El-Aksa. Udhëheqësit kryesorë të saj janë avokatët Rabinoviç dhe Solomon. Ky i fundit kryeson edhe grupimin El Har Hashem.

10. LËVIZJA "RIKTHIMI I KURORËS ASHTU SIÇ ISHTE MË PARË"

E kryesuar nga Jizrael Fojhtvanger, kjo lëvizje drejton një grup të dhunshëm të rinjsh fanatikë çifutë që punojnë për shtënien në dorë të shumë ndërtesave në Jeruzalem më pretendimin se një herë e një kohë kanë qenë pronë e çifutëve. Pasi i shtien në dorë ato, përgatisin dokumentat për t'i ligjëruar ato si prona çifute. Qëllimi i tyre është marrja e lagjes islame në Kuds, në mënyrë që Xhamia El-Aksa të rrethohet nga të gjitha anët nga pronat çifute.

11. GRUPIMI HASHMONAIM

Anëtarët e këtij grupimi të drejtuar nga terroristi Lerner njihen për përdorimin e dhunës së egër. Menjëherë pas përfundimit të shërbimit ushtarak, ata i përkushtohen qëllimit të tyre përfundimtar: pushtimit me dhunë të sheshit të Xhamisë El-Aksa, duke mos përfillur politikën e hapave të njëpasnjëshëm që ndjek qeveria çifute për të arritur të njëjtin qëllim. Në vitin 1982, ky grupim u përpoq të hidhte në erë Kubenë e Shkëmbit, por përpjekja dështoi, sepse Allahu i Plotfuqishëm bëri që të zbuloheshin ngarkesat me eksploziv përpara se të shpërthenin.

12. LËVIZJA SIJONMENT (SIONIZMI I RI)

Kjo lëvizje është themeluar në tetor të vitit 1983 nga ish-shefi i shtatmadhorisë së ushtrisë izraelite Rafael Itan, i njohur për ekstremizmin dhe egërsinë e tij të pashoq kundër arabëve muslimanë në kohën kur ishte në atë post. Lëvizja përqëndrohet rreth sionizmit si drejtim dhe synon t'i rikthejë lavdinë "tokës së Izraelit", simbolit të fitores çifute.

13. LËVIZJA EMNA (PREMTIMI)

EMNA është organizim kolonist, në udhëheqjen e të cilit bëjnë pjesë një numër të rinjsh fanatikë çifutë të dalë nga shkollat fetare, që dallohen nga takijet e tyre karakteristike. Nëpërmjet kësaj lëvizjeje, këta të rinj përhapin tek çifutet botëkuptime shoqërore që rrjedhin nga besimi i tyre fetar në afrimin e shpëtimit që do të vijë me shfaqjen e Mesisë. Lëvizja bën thirrje për mosbindje dhe rebelim ndaj institucioneve të shtetit nëse veprimet e tyre bien ndesh me mësimet e Teuratit. Ajo punon me ngulm për ndalimin e tërheqjes nga rajonet e pushtuara duke shtënë në dorë dhjetëra koloni dhe duke i çifutizuar krejt ato.

14. FISI JEHUDA

Këta janë të njohur me emrin banda LEFTA. Kjo bandë është përpjekur të hedhë në erë Xhaminë El-Aksa dhe Kubenë e Shkëmbit, duke vendosur eksplozivë për qark tyre, por pa sukses. LEFTA gëzon një ndikim të madh tek çifutët dhe zotëron një arsenal të madh ushtarak.

15. LËVIZJA KAH (KËSHTU!)

Themeluesi i saj është rabini çifuto-amerikan Majer Kahana, anëtar i Knesetit izraelit. Ky rabin çifut është i njohur për pikëpamjet e tij talmudike që bëjnë thirrje për dëbimin më dhunë të të gjithë muslimanëve nga Palestina, në mënyrë që të mbetet vetëm e çifutëve. Ai e zbaton atë që beson, duke ju dërguar letra kërcënuese udhëheqësve islamë në Palestinën e pushtuar. Nga ithtarët e tij është edhe Valen Godman, i cili më 11 prill 1982 kreu një sulm kundër Xhamisë El-Aksa, si pasojë e të cilit u vranë dhe u plagosën shumë muslimanë. Vetë Kahana u pagoi shuma të mëdha avokatëve që arritën ta lironin Godmanin nga të gjitha paditë.

16. SHOQATA "FONDI I MALIT TË TEMPULLIT"

Kjo shoqatë është shoqatë sioniste kristiano-çifute që punon haptas për çifutizimin e rajonit të Xhamisë El-Aksa. Themelimi i saj në vitin 1983 u shpall njëkohësisht në SHBA dhe Izrael, me kusht që qendra të ishte në Jeruzalem. Financimi i saj bëhet nga të krishterët amerikanë. Në Kaliforni ajo drejtohet nga pasaniku amerikan Terri Rezenhofer. Në numrin e saj të datës 23 janar 1983, gazeta izraelite "Davar" botoi lajmin se lidhja "Fondi i Malit të Tempullit" do të dhuronte dhjetëra milionë dollarë për ngritjen e kolonive çifute në Jehuda dhe Samara. Kjo shoqatë ka për qëllim themelor rindërtimin e Tempullit të Tretë mbi Malin Sion.

17. LËVIZJA "MBROJTËSIT E SHESHIT TË TEMPULLIT"

Qëllimi më i rëndësishëm i tyre është pushtimi i tokës së El-Aksasë dhe Shkëmbit, së bashku me rrethinat. Këtë lëvizje e drejton avokati Gershon Solomon, i cili drejton edhe dy organizime të tjera, El Har Hashem dhe Betar.

18. LIDHJA SIJORI CION

Kjo është një lidhje vullnetare që punon nën mbikqyrjen e shkollave fetare. Nga anëtarët e saj me të shquar përmendim Zev Ensig, i cili thotë se qëllimet e

lidhjes janë: "...rritja e ndërgjegjësimit për Tempullin dhe Jeruzalemin tek çifutët dhe në mënyrë të veçantë, tek ushtarët".

19. ORGANIZIMI I FSHEHTË BRENDË USHTRISË IZRAELITE

Përmasat e këtij organizimi akoma nuk janë të qarta. Ekzistenca e tij u zbulua në vitin 1984, gjatë përgatitjeve të tij për bombardimin e Xhamisë El-Aksa nga ajri nëpërmjet armës së aviacionit izraelit, plan i cili synonte zhdukjen nga faqja e dheut të Xhamisë. Analistë politikë në Izrael thonë se shumica e anëtarëve të këtij organizimi nuk bëjnë pjesë në organizatat e njohura fanatike sioniste.

SULMET SIONISTE KUNDËR XHAMISË EL-AKSA DHE XHAMISË SË SHKËMBIT

Që nga pushtimi çifut i Kudsit e deri më sot, sulmet sioniste kundër vendeve të shenjta islame nuk kanë rreshtur asnjëherë dhe ajo që duket nga sjelljet e tyre gjatë tërë kësaj periudhe është se ata nuk duan që të heqin dorë prej tyre derisa t'i japin Bejtul-Makdisit ngjyrimin e pastër çifut. Por kjo gjë nuk mund të realizohet pa u zhdukur përfundimisht monumentet e përrjetshme islame në ato vende të shenjta, posaçërisht Xhamia El-Aksa dhe Xhamia e Shkëmbit.

Nëse analizojmë hollësisht sulmet e përsëritura çifute kundër El-Aksasë dhe Shkëmbit duke ndjekur rrjedhën e tyre kronologjike, na shfaqen shumë gjëra të rëndësishme, që na tregojnë se gjendemi përpara një situatë serioze. Dhe kjo sepse:

1. Planet çifute intensifikohen duke u shtuar dhe duke u bërë gjithnjë e më të rrezikshme
2. Palët pjesëmarrëse në komplot me kalimin e ditëve shtohen dhe sofistikohen, duke këmbëngulur në arritjen e qëllimit të tyre
3. Reagimet, bile edhe ato vetëm me fjalë, në botën arabe dhe atë islame nuk janë në nivelin e ngjarjeve, që mund të shpjegohen ose me mosnjohjen e përmasave të komplotit ose me një nënvlerësim dhe përçmim të tij
4. Qëndrimi zyrtar i qeverive izraelite fshihet pas grupimeve dhe organizatave që komplotojnë kundër El-Aksasë. Kur ndodh ajo që pritej, thonë se janë grupimet ekstremiste, është terrorizmi që gjoja dënojnë, arrestojnë një ose disa persona apo grupe duke i mbyllur si heronj pas hekurave, bile disa raste edhe shpallin dënimin me vdekje të tyre, pasi këta të fundit të kenë fituar përpara syve të popullit çifut nderin e lartë të realizimit të ëndrrës dymijëvjeçare.
5. Vemë re se sulme të shumta kanë dështuar thjesht sepse Allahu i Lartësuar me fuqinë e Tij e ka mbrojtur Xhaminë, të cilën muslimanët, me përjashtim të besimtarëve të ndershëm e të pambrojtur nga populli palestinez, akoma nuk janë ngritur për ta mbrojtur.

6. Duke parë qëndrimin zyrtar izraelit del qartë se qeveria çifute preferon që komploti të realizohet si pasojë e "ndodhjeve të papëlqyera", "grupimeve të papërgjegjshme", "individëve të çmendur" apo çdo ndodhje që të duket si diçka natyrore si psh ndonjë tërmet. E rëndësishme është që ajo të dalë e papërljer. Për realizimin e kësaj, vazhdojnë pa pushim gërrmimet e nëndheshme nën themelet e Xhamisë El-Aksa.

KOMPLOTI I GËRRMIMEVE

Që kur e pushtuan Jeruzalemin, çifutët janë munduar vazhdimisht të gjejnë ndonjë gjurmë antike që të dëshmojnë se vendndodhja e Xhamisë është tamam vendi ku ngrihej më parë Tempulli i Sulejmanit, por a është ky i vetmi qëllim për të cilin kryhen gërrmimet e nëndheshme?

Çifutët janë një komb gënjeshtar, mashtrues dhe i pabesë. Ata kanë një qëllim më të largët dhe më të rrezikshëm se ai që shfaqin. Të përpiqemi që të njihemi me këtë qëllim duke medituuar mbi aspektet e komplotit të gërrmimeve. Që nga lufta e qershorit të vitit 1968, operacionet e gërrmimeve kanë kaluar në dhjetë faza.

Faza e parë: Kjo fazë fillon menjëherë pas Luftës së Qershorit, kur çifutët shkatërruan përfundimisht lagjen e Marokenëve që vendi të ishte i lirë për kryerjen e punimeve të gërrmimit. Gërrmimet në këtë fazë vazhduan një vit të tërë dhe thellësia e tyre arriti në 14 metra.

Faza e dytë: Operacionet e shkatërrimit vazhduan në lagjet islame, banorët e të cilave u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Në këtë fazë, në vitin 1969, ndodhi djegia e Xhamisë El-Aksa. Gjatë atyre viteve, mbi gërrmadhat e ndërtesave arabe muslimane u ndërtuan shumë institute, shkolla fetare, vendpushime, hotele etj. Gërrmimet vazhduan dhe kapën një shtrirje prej 80 metrash përreth murit rrethues duke kaluar përqark ndërtesave islame atje.

Faza e tretë: Gjatë viteve 1970-1972 filloi gërrmimi i tuneleve nën muret rrethues të Xhamisë El-Aksa në dy anë: atë jugore dhe atë perëndimore, derisa u arrit që tunelet të shtriheshin nën sheshin e Xhamisë. Në këtë fazë vazhdoi procesi i rrëmbimit të shumë ndërtesave islame që rrethonin Xhaminë, ndër ta edhe ndërtesa e Gjykatës së Sheriatit.

Faza e katërt: Në vitin 1973, gërmimet arritën në murin perëndimor të Xhamisë dhe depërtuan në një distancë të madhe poshtë saj. Thellësia e tyre asokohe arriti më shumë se 13 metra.

Faza e pestë: Gjatë vitit 1974, gërmimet u zgjeruan nën murin perëndimor.

Faza e gjashtë: Gjatë viteve 1975-76 vazhdoi zgjerimi i gërmimeve nën murin perëndimor. Çifutët shkatërruan një varrezë islame në të cilën gjendeshin varret e dy sahabeve të shquar: Ubade ibn Samit dhe Sheddad ibn Eus (r.a.).

Faza e shtatë: Në vitin 1977 gërmimet arritën nën xhaminë e grave që gjendet brenda Xhamisë El-Aksa. Një komision i një ministrie izraelite dha pëlqimin për realizimin e një projekti i cili parashikonte konfiskimin e trojeve të tjera përreth sheshit të Xhamisë dhe prishjen e ndërtesave të ndërtuara mbi to deri në një thellësi prej 9 metrash.

Faza e tetë: Në vitin 1979 filluan gërmime të reja nën murin perëndimor pranë Murit të Burakut. U hap një tunel i gjërë dhe i gjatë, si dhe u vendos që të vazhdonin punimet në të derisa ta përshkonte Xhaminë nga perëndimi në lindje. Tuneli u përforcua me betonarme dhe në të u ngrit një sinagogë e vogël çifute, e cila u përrua zyrtarisht nga presidenti dhe kryeministri çifut, duke u konsideruar si një tempull i përkohshëm.

Faza e nëntë: Në vitin 1986, gërmimet u intensifikuan nga të gjitha drejtimet. Një numër i madh banorësh të Kudsit të vjetër u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Autoritetet çifute të pushtimit mbyllën një spital palestinez që ndodhej brenda kështjellës së vjetër. Shumë shtëpi arabe u rrëmbyen me forcë, ndërsa Sharoni u ngulit për të banuar në truallin e njërës prej tyre për të vërtetuar çifutizimin e Kudsit.

Faza e dhjetë: Kjo fazë filloi me shumë egërsi. Depërtimi i nëndheshëm u intensifikua edhe më shumë nën sheshin e Xhamisë dhe rrethinat e saj. Ndërkohë që ruajtësit muslimanë mbronin Xhaminë nga brenda kundër çdo agresioni të mundshëm, rrëmihësit çifutë vazhdonin gërmimet nga jashtë mureve rrethuese dhe nga lagjet që kontrolloheshin nga forcat ushtarake çifute. Tani gërmimet u përqëndruan në shtresat e nëndheshme me qëllim krijimin e zgavrave që do të çonin në shembjen e Xhamisë.

Në muajin gusht të vitit 1988, rrëmihësit çifutë u përpoqën të nisnin gërrmimet në mes të rrugës që zbrit për në lagjen Uadi, e cila është ngjitur me Xhaminë, por ruajtësit e saj i ndaluan ata. Gërrmuesit i përsëritën disa herë përpjekjet, por u ndaluan po aq herë nga ruajtësit vigjilentë. Qëllimi i tyre ishte që të mbërrinin në themelet e Xhamisë së Shkëmbit dhe që andej të arrinin tek gërrmimet e tjera nën murin perëndimor të Xhamisë El-Aksa. Zyra e vakëfeve islame të Kudsit e kuptoi komplotin dhe ngriti një gardh rreth truallit ngjitur me murin lindor për të ndaluar gërrmimet atje. Kur morën vesh për ngritjen e gardhit, autoritetet e pushtimit filluan ta kërcënojnë drejtorin e vakëfeve islame që ta hiqte gardhin gjoja se ai ishte ngritur pa lejen e tyre, por ai ju përgjigj se trualli ishte vakëf islam, ndaj kujdestarët e tij nuk kishin nevojë të merrnin leje nga askush. Duke parë këmbënguljen e drejtorit, autoritetet e pushtimit e hodhën atë në gjyq, i cili vazhdoi deri në muajin dhjetor 1988.

Faza e dhjetë përfaqëson fazën më të rrezikshme, sepse qëllimi i çifutëve pas të gjithë këtyre përpjekjeve është boshatisja e nëntokës së dy xhamive dhe kështu, duke mbetur pezull mbi boshllëk, ato rrezikohen që të shemben (mos dhëntë Zoti!) si pasojë e ndryshimeve atmosferike të motit, dridhjeve të tokës, bile edhe zhurmës së madhe të shkaktuar nga ndonjë avion që kalon murin e zërit. A e kuptuat tani ndyrësinë dhe poshtërsinë e këtij komploti?!

SULMET DHE PËRPJEKJET PËR SULM QË NGA FILLIMI I PUSHTIMIT

Krahas komplotit të gërrmimeve të studiuar mirë dhe të ndarë në faza, që nga pushtimi çifut i Bejtul-Makdisit janë bërë shumë përpjekje frenetike dhe të tërbuara për shkatërrimin e Xhamisë El-Aksa dhe asaj të Shkëmbit. Le t'i ndjekim ato sipas rendit kronologjik:

- Pikërisht më 28 qershor 1968, menjëherë pas hyrjes së çifutëve në Kuds, në të u mbajt një konferencë e të gjithë rabinëve çifutë të botës ku u diskutua rreth çështjes së Kudsit dhe Tempullit. Të pranishmit kërkuan përsheptimin e procesit të rindërtimit të Tempullit.
- Më 15 gusht 1968, kryerabini i Izraelit dhe ushtrisë çifute Shlomo Gurin, i veshur me uniformë ushtarake dhe i shoqëruar nga 20 oficerë, hyri në sheshin e Xhamisë El-Aksa duke tundur në mënyrë hysterike automatikun dhe

duke qëlluar sa andej këtej. Së bashku me oficerët që e shoqëronin, ai kreu ritet fetare çifute.

- Më 31 gusht 1968, me urdhër të kryerabinit të ushtrisë së mbrojtjes së Izraelit, ushtria çifute shtiu në dorë çelësin e Portës së Marokenëve, gjë që u lehtësoi atyre futjen në Murin e Pikëllimit sa herë të donin.

- Më 21 gusht 1969, një i krishterë nga Australia i quajtur Denis Majkëll i vuri zjarrin Xhamisë El- Aksa. Gjuhët e mëdha të flakës dogjën pajisjet e xhamisë, muret dhe minberin e saj të madh, të cilin Salahuddin Ejjubi e pati përgatitur për mbajtjen e hutbeve të xhumasë menjëherë pas çlirimit të Kudsit nga kryqtarët. Pas një gjykimi farsë, gjatë të cilit ai deklaroi se ishte dërguar nga Zoti dhe e kishte kryer këtë veprim i mbështetur në një profeci biblike të librit të Zekerijas, ky kriminel u lirua pa i hyrë gjemb në këmbë, sepse gjoja ishte i çmendur!

- Më 11 mars 1971, Gershon Solomon, udhëheqësi i grupimit El Har Hashem, në krye të një grupi studentësh fanatikë u përpoq të kryente me forcë ritet fetare çifute në Xhaminë El-Aksa, përpjekje e cila çoi në trazira të mëdha në Kuds.

- Më 30 janar 1976, një gjykatë çifute konfirmoi "të drejtën e çifutëve për t'u lutur në sheshin e Xhamisë sa herë të donin dhe në cilëndo orë të ditës". Këtë vendim ajo e mori pasi liroi si të pafajshëm 40 çifutë të akuzuar se ishin futur me forcë brenda Xhamisë El-Aksa duke kënduar këngë çifute, veprim i cili shkaktoi një varg përleshjesh ndërmjet tyre dhe muslimanëve në sheshin e xhamisë.

- Më 14 gusht 1978, Gershon Solomon, së bashku me disa çifutë të tjerë që e shoqëronin, u përpoq të kryente lutjet çifute në El-Aksa, por rojet e xhamisë i ndaluan ata.

- Në fillim të muajit maj të vitit 1980, u bë një përpjekje e dështuar për hedhjen në erë të Xhamisë. Mbi çatinë e njëres prej sinagogave çifute që ndodhen afër Xhamisë, u zbulua më shumë se një ton eksploziv. Gjithashtu një ngarkesë tjetër eksplozivi e përgatitur për të njëjtin qëllim u zbulua në shkollën çifute Basheva. Për këtë çështje u gjykua terroristi Majer Kahana.

- Më 9 gusht 1981, më shumë se 300 anëtarë të grupimit Gosh Emonim u tubuan pranë Xhamisë El-Aksa, arritën të thyejnë drynin e Portës së Hekurit dhe kryen lutjet çifute duke provokuar muslimanët.
- Më 25 gusht 1981, shoqatat fetare çifute njoftuan për zbulimin e një tuneli që fillonte në Murin e Burakut dhe të çonte deri në oborrin e Xhamisë, i cili sipas tyre kishte lidhje me Tempullin e dytë. Menjëherë pas kësaj filluan gërmime që rrezikuan shembjen e mureve të xhamisë.
- Më 2 mars 1982, 15 anëtarë të grupimit "Kujdestarët e Malit të Tempullit" të armatosur me armë zjarri, u futën me forcë në një nga portat e jashtme të Xhamisë, sulmuan ruajtësit e saj dhe u përleshën me ta. Gjatë përleshjes u plagos me thikë njëri nga ruajtësit. Të nesërmen, muslimanët bënë një grevë të përgjithshme në Kuds në shenjë proteste ndaj këtyre provokacioneve, ndërsa një valë demonstratash përfshiu qytetet e Bregut Perëndimor, Nablusin dhe Bejt-Lahmin.
- Më 3 mars 1982, një grup të rinjsh fanatikë çifutë tentuan të kapërcenin portën El-Gavanimë, por u ndeshën me ruajtësit e Xhamisë dhe u përleshën me ta. Si pasojë u plagos njëri nga ruajtësit. Me të mbërritur në vend, policia izraelite arrestoi ruajtarin e plagosur dhe mori në pyetje ruajtësit e tjerë.
- Më 8 prill 1982, banorët muslimanë gjetën një pako të dyshimtë pas një rës nga dyert kryesore të Xhamisë. Pasi e hapën atë, gjetën brenda saj tela elektrikë, një detonator dhe një letër që i drejtohej Këshillit të Vakëfeve Islame ku shkruhej: "Pritni dhe do të shikoni edhe më shumë sulme kundër jush!" Të nesërmen, muslimanët falën xhumanë dhe u bashkuan në një protestë kundër këtyre kërcënimeve.
- Më 11 prill 1982, një ushtar çifut i quajtur Alan Godman u fut në Xhaminë El-Aksa nëpërmjet portës El-Gavanimë. I armatosur me automatik, ai qëlloi ruajtësin e portës dhe e plagosi. Pastaj u vërsul si i çmendur drejt Xhamisë së Shkëmbit, duke qëlluar barbarisht mbi besimtarët që po faleshin në të. Për pasojë u plagosën shumë prej tyre dhe u vra njëri nga ruajtësit e Xhamisë. Ky sulm u mbështet nga shumë ushtarë çifutë të përqëndruar mbi çatitë e shtëpive që ndodheshin ngjitur më Xhaminë, të cilët filluan të qëllonin drejt Xhamisë së Shkëmbit. Atëherë muezinët nëpërmjet altoparlanteve u

filluan t'u bënin thirrje të gjithë banorëve muslimanëve që të drejtoheshin menjëherë në sheshin e Xhamisë për ta mbrojtur. Muslimanët u vërsulën drejt Xhamisë, por ushtarët çifutë të stacionuar mbi çatitë e shtëpive fqinje filluan të qëllonin me armë mbi to, si pasojë e të cilës u vranë dhe u plagosën më shumë se 100 vetë. Kur muftiu i Kudsit, shejh Saaduddin El-Alemij, bëri përgjegjëse për këtë sulm qeverinë izraelite, kjo e fundit, nëpërmjet një deklarate të kabinetit të kryeministrit Menahem Begin, u hodh në kundërsulm. Në deklaratë thuhet: "Këshilli Islam duhet ta dijë mirë se koha e muftiut Emin El-Husejni ka kaluar për të mos u kthyer më kurrë". Kjo ngjarje shkaktoi një jehonë të madhe në arenën ndërkombëtare, ndaj më 20 prill 1982, Këshilli i Sigurimit i OKB-së u mbledh për të diskutuar këtë ngjarje. Ai përgatiti një projekt-rezolutë, në të cilën dënohej Izraeli për këtë ngjarje, por ShBA-ja vuri veton dhe e hodhi poshtë atë!

- Më 28 prill 1982, një grup i përbërë nga rreth 100 çifutë nën udhëheqjen e rabinit çifuto- amerikan Majer Kahana, udhëheqësit të lëvizjes Kah, u orvat të futej me forcë në Xhaminë El- Aksa. Ata mbanin në duar pankarta ku bëhej thirrje për dëbimin e të gjithë arabëve nga Palestina si dhe një fotografi të madhe të shesheve të El-Aksasë, në të cilën në vendin e dy xhamijave ishte vendosur Tempulli i tyre i tretë.

- Më 29 prill 1982, një grup i armatosur i përbërë prej 30 vetave u orvat të futej me dhunë në Xhami, por u ndesh me rezistencën e ruajtësve muslimanë.

- Më 6 maj 1982, disa të panjohur qëlluan me armë Kubenë e Shkëmbit. Menjëherë ruajtësit e Xhamisë mbyllën të gjitha dyert e saj. U bë e qartë se një kolonist çifut kishte qëlluar me armë Xhaminë nga një shkollë afër saj.

- Po në të njëjtin vit 1982, terroristi Ariel Lerner u përpoq të hidhte në erë Xhaminë së Shkëmbit. Për këtë qëllim ai kishte krijuar një lëvizje të fshehtë të përbërë nga një numër të rinjsh çifutë. Lerner kishte bërë plane për hedhjen në erë edhe të xhamive të tjera në atë rajon.

- Në të njëjtin vit, rabini Arnel i Fakultetit Civil në Kirjat Erba, në krye të rreth 20 nxënësve të tij u mundua të futej me forcë në Xhami.

- Në vitin 1983, disa të rinj çifutë, ndjekës të rabinit Zelman Koren, u orvatën të hyjnë me forcë në Xhaminë El-Aksa. Pas gjykimit të tyre dhe dhënies së verdiktit mbi pafajësinë e tyre, gjykatësi izraelit qortoi policinë për arrestimin e tyre dhe i liroi ata më 21 shtator 1983.

- Në gusht të vitit 198, disa çifutë anëtarë të grupimit "Kujdestarët e Tempullit" kryen ritet e tyre çifute në sheshin që rrethon Murin e Burakut, ngjitur me Xhaminë.

- Në maj të vitit 1984, u bë një përpjekje kriminale për hedhjen në erë të Xhamisë El-Aksa dhe asaj të Umerit (r.a.), por ruajtësit e tyre bënë që me ndihmën e Allahut të Lartësuar plani të dështojë.

-Më 12 mars 1984, një grup anëtarësh të disa organizatave fanatike çifute u përpoqën të futen me forcë në banesat mgjitur me Xhaminë El-Aksa me qëllim ngritjen e një kolonije dhe një shkolle fetare çifute.

- Në muajin korrik 1984, një ekstremist çifut u mundua të futej me forcë në El-Aksa me veturën e tij.

- Në fillim të gushtit të vitit 1984, ruajtësit e Xhamisë zbuluan një numër terroristësh çifutë në sheshet përreth saj, të cilët po përgatiteshin të hidhnin në erë të gjithë Xhaminë. Për këtë qëllim ata kishin përgatitur bomba dhe lëndë eksplozive shumë të fuqishme. Pas kësaj ngjarjeje, muftiu i Kudsit Saaduddin El-Alemij tha: "Sikur të mos ishte kujdesi i Allahut (xh.sh.), nuk do të kishte mbetur gur mbi gur nga kjo ndërtesë e shenjtë".

- Në gusht të vitit 1984, lajme të ardhura nga Toka e Pushtuar bënë të ditur se autoritet izraelite të pushtimit vendosën ringritjen e flamurit izraelit brenda shesheve të El-Aksasë, në zbatim të vendimit të ministrit të brendshëm izraelit të asaj kohe Jozef Burg. Më parë ato e kishin ngritur atë për tre javë, por u detyruan ta ulin pas protestave të Këshillit Islam në Kuds.

- Më 7 gusht 1984, rabini çifuto-amerikan Majer Kahana, udhëheqësi i lëvizjes Kah, u përpoq të profanonte Xhaminë El-Aksa duke ngritur flamurin izraelit. Në përvjetorin e shkatërrimit të tempullit të vjetër, ai e ngjiti atë mbi njërën nga dyert e Xhamisë, pasi trokiti me forcë në derë. Mijëra çifutë kryen asokohe ritet fetare çifute pranë Xhamisë El-Aksa.

- Më 9 gusht 1984, një raport i ministrisë jordanëze të punës bëri të ditur se autoritetet e pushtimit filluan nga puna për ngritjen e tre kampeve të përqëndrimit, një në Kuds pranë Xhamisë El-Aksa dhe dy të tjerët në Halil dhe Nablus. Natyrisht është e qartë qëllimi i ngritjes së një kampi pranë El-Aksasë.
- Më 27 gusht 1984, në një shpellë të qytetit të Kudsit u zbulua një sasi e madhe armësh, e cila i përkiste njëres nga grupimeve ekstremiste çifute, ndërsa një kalimtar zbuloi një bombë në sektorin lindor të qytetit.
- Më 28 gusht 1984, një student çifut u dënua me burgim për shkak se u akuzua se planifikonte hedhjen në erë të Xhamisë El-Aksa, por u lirua më pas si pasojë e përpjekjeve të bëra për këtë qëllim.
- Më 18 dhjetor 1984, u zbulua një përpjekje e dështuar çifute për hedhjen në erë të El-Aksasë, kur elementë të rojës kufitare izraelite vendosën një bombë të fuqishme në sheshin kryesor të xhamisë, por ruajtësit e saj e zbuluan dhe e çaktivizuan atë. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje u organizua një grevë e përgjithshme në qytetin e Kudsit.
- Më 9 janar 1986, forca të rojes kufitare izraelite vendosën gjendjen e shtetrrrethimit në rajonin e Xhamisë El-Aksa dhe arrestuan një numër të madh besimtarësh dhe ruajtësish të xhamisë, menjëherë pasi u përballën me anëtarët e komisionit të punëve të brendshme të Knesetit çifut. Kjo ishte e para përpjekje zyrtare për agresion kundër Xhamisë El-Aksa.
- Më 3 prill 1986, policia izraelite shkuli me forcë një derë që kishin ngritur ruajtësit muslimanë për të ndaluar infiltrimin e çifutëve në xhami natën.
- Më 29 prill 1986, duke përdorur forcën, një grup anëtarësh të organizatës "Kujdestarët e Malit të Tempullit" nën udhëheqjen e Gershon Solomonit, u futën në Xhaminë El-Aksa ku kryen ritet e tyre çifute.
- Më 21 gusht 1986, nën mbrojtjen e policisë izraelite, një grup i përbërë nga anëtarë të dy organizatave "Kujdestarët e Malit të Tempullit" dhe partisë Hit-hija u futën me dhunë në sheshin e El-Aksasë ku kryen ritet e tyre fetare. Kjo gjë ndodhi gjatë festimeve muslimane të festës së bekuar të Kurban-Bajramit.

- Më 17 mars 1989, ruajtësit muslimanë zbuluan një sasi të madhe bombash të vendosura brenda Xhamisë El-Aksa nga një grupim terrorist çifut pët të hedhur në erë xhaminë.

- Më 17 tetor 1989, grupimi çifut "Kujdestarët e Malit të Tempullit" vendosën gurin e përrimit të ndërtimit të Tempullit të tretë në afërsi të hyrjes së Xhamisë El-Aksa. Guri peshonte 3,5 ton. Me rastin e kësaj ngjarjeje, kryetari i grupimit Gershon Solomon tha: "Vendosja e këtij guri përfaqëson fillimin e një etape të re historike" dhe shtoi: "Pushtimi islam ka përfunduar. Ne duam të fillojmë një epokë të re, atë të çlirimit të popullit çifut".

Me këtë ngjarje, çifutët u futën në fazën e tretë dhe të fundit të komplotit kundër Xhamisë El-Aksa, pasi realizuan dy të parat: marrjen e Murit të Pikëlimit dhe truallit të Xhamisë El-Aksa. Përpara tyre nuk ka mbetur veçse ndërtimi... ose gjaku.

Lavdërimi i përket vetëm Allahut të Lartësuar me ndihmën e të cilit përfundoi përkthimi i kësaj vepre. Paqja dhe bekimet e tij qofshin mbi Muhammedin (a.s.), familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën dhe udhëzimin e tij deri në Ditën e Gjykimit. Amin!

Përmbajtja

PARATHËNIE.....	2
ARMIQËSIA E ÇIFUTËVE KUNDËR ISLAMIT DHE PASUESVE TË TIJ NË KOHËRAT E VJETRA DHE SOT ARMIKU YNË I VJETËR	4
ARMIKU YNË I RI.....	8
FAKTE PËR XHAMINË EL-AKSA DHE TOKËN E SHENJTË PËRPARA DËRGIMIT TË MUHAMMEDIT XHAMIA EL-AKSA DHE SHKËMBI	15
1. NË KOHËN E IBRAHIMIT (A.S.).....	16
2. NË KOHËN E IS-HAKUT (A.S.) DHE JA'KUBIT (A.S.)	16
3. NË KOHËN E MUSAIT (A.S.).....	16
4. NË KOHËN E JUSHUA IBN NUNIT (A.S.).....	17
5. PAS KOHËS SË JUSHUA IBN NUNIT (A.S.)	17
6. NË KOHËN E DAVUDIT (A.S.)	18
7. NË KOHËN E SULEJMANIT (A.S.).....	18
8. PAS KOHËS SË SULEJMANIT (A.S.).....	18
9. RËNIA E DY MBRETËRIVE DHE SHKATËRRIMI I PARË I TEMPULLIT	19
10. KOHA E KTHIMIT NGA ROBËRIA DHE RINDËRTIMI I TEMPULLIT	19
11. ROMAKËT PUSHTOJNË TOKËN E SHENJTË	20
12. TEMPULLI NË KOHËN E ZEKERIJAS (A.S.) DHE JAHJASË (A.S.)	20
13. TEMPULLI NË KOHËN E ISAIT (A.S.).....	20
14. SHKATËRRIMI I DYTË I TEMPULLIT	21
15. NGRITJA E NJË TEMPULLI PAGAN NË VEND TË XHAMISË EL-AKSA....	21
16. SHKATËRRIMI I TEMPULLIT PAGAN	21
17. FUNDI I HEGJEMONISË ÇIFUTE DHE ASAJ TË KRISHTERË MBI TOKËN E XHAMISË EL-AKSA	22
TOKA E SHENJTË DHE XHAMIJA EL-AKSA NËN HIJEN E ISLAMIT.....	23
1. NË KOHËN E TË DËRGUARIT (S.A.V.S.)	28
2. NË KOHËN E EBU BEKR ES-SIDDIKUT (R.A.).....	29
3. NË KOHËN E OMER IBN EL- HATTABIT (R.A.)	29
4. NË KOHËN E EMEVIJVE.....	30

5.	NË KOHËN E ABBASIJVE	30
6.	NË KOHËN E TOLONIJVE DHE IHSHIDIJVE	31
7.	NË KOHËN E TURQVE SELXHUKË.....	31
8.	RËNIA E KUDSIT NË DUART E PUSHTUESVE KRYQTARË.....	31
TOKA E SHENJTË DHE TEMPULLI NË MENDIMIN DHE NDJENJAT E ÇIFUTËVE...		33
1.	TEURATI DHE TEMPULLI.....	34
2.	TALMUDI DHE TEMPULLI	36
3.	"PROTOKOLLET E TË URTËVE TË SIONIT" DHE TEMPULLI	37
4.	SIONIZMI DHE TEMPULLI	38
5.	MASONIZMI DHE TEMPULLI	40
DOKTRINA MBI MESINË E PRITUR TEK ÇIFUTËT DHE TË KRISHTERËT. LIDHJA QË EKZISTON NDËRMJET SAJ DHE RINGRITJES SË TEMPULLIT		43
1.	BESIMI I ÇIFUTËVE TEK MESIA I TYRE I PREMTUAR	43
2.	BESIMI I TË KRISHTERËVE TEK MESIA I PRITUR.....	46
BESIMI NË DITËN E MEGIDOS OSE HARMAGEDONIT		49
SHOQATAT, ORGANIZATAT DHE PERSONALITETET ÇIFUTE DHE TË KRISHTERA QË KANË GISHT NË KOMPLOTIN KUNDËR XHAMISË EL-AKSA		52
AKTIVITETI KISHTAR		52
EVANGJELISTËT OSE SIONISTËT E KRISHTERË		53
ORGANIZATAT E KRISHTERA QË KANË GISHT NË KOMPLOTIN KUNDËR XHAMISË EL-AKSA		54
1.	AMBASADA BOTËRORE E KRISHTERË NË JERUZALEM	55
2.	SHOQATA E SHUMICËS MORALE	55
3.	SHOQATA FETARE "TRYEZA E RRUMBULLAKËT".....	56
4.	FONDACIONI "MALI I TEMPULLIT"	56
ORGANIZATAT DHE GRUPET ÇIFUTE TË INTERESUARA PËR PRISHJEN E XHAMISË EL-AKSA DHE NDËRTIMIN E TEMPULLIT		56
1.	GRUPIMI GOSH EMONIM.....	56
2.	ORGANIZATA "JESHIFAT ETRIT KOHANEN" (KURORA PRIFTËRORE)..	57
3.	LËVIZJA PËR PUSHTIMIN E XHAMISË EL-AKSA	57

4.	ORGANIZATA SEJUDOS SHESHON.....	57
5.	GRUPIMI EL HAR HASHEM.....	58
6.	PARTIA HIT-HIJA (RIZGJIMI SIONIST).....	58
7.	GRUPIMI "KUJDESTARËT E TEMPULLIT"	58
8.	FONDACIONI "TEMPULLI I SHENJTË"	58
9.	ORGANIZATA BETAR	58
10.	LËVIZJA "RIKTHIMI I KURORËS ASHTU SIÇ ISHTE MË PARË"	59
11.	GRUPIMI HASHMONAIM	59
12.	LËVIZJA SIJONMENT (SIONIZMI I RI)	59
13.	LËVIZJA EMNA (PREMTIMI).....	59
14.	FISI JEHUDA.....	60
15.	LËVIZJA KAH (KËSHTU!).....	60
16.	SHOQATA "FONDI I MALIT TË TEMPULLIT"	60
17.	LËVIZJA "MBROJTËSIT E SHESHIT TË TEMPULLIT"	60
18.	LIDHJA SIJORI CION	60
19.	ORGANIZIMI I FSHEHTË BRENDË USHTRISË IZRAELITE.....	61
	SULMET SIONISTE KUNDËR XHAMISË EL-AKSA DHE XHAMISË SË SHKËMBIT ...	62
	KOMPLOTI I GËRRMIMEVE	63
	SULMET DHE PËRPPJEKJET PËR SULM QË NGA FILLIMI I PUSHTIMIT	65